



DISKRIMINIMI NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

**Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit
për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**



DISKRIMINIMI NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

**Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit
për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rr. "Bogdani"

Nr. 1, Tiranë

Tel/Fax: +3554269426

www.adrf.al

E-mail: info@adrf.al

Përmbajtja e Lëndës

HYRJE.....3

METODOLOGJIA.....7

PJESA I:

KOMITETI PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TËKUFIZUARA 9

Komunikimi Nr. CRPD / C / 20/D/35/2016: J.H.
(përfaqësuar nga këshilltarja, Michele Hardesty-Munday) kundër Australisë 9

Komunikimi Nr. 39/2017: Iulija Domina dhe Max Bendtsen
(përfaqësuar nga avokati, Eddie Kawaja) kundër Danimarkës 14

Komunikimi Nr. 23/2014, Y kundër Republikës së Bashkuar të Tanzanisë 19

Komunikimi Nr. 26/2014: Simon Bacher
(përfaqësuar nga Viktoria Bacher, motra e tij binjake dhe kujdestare ligjore) .. 26

Komunikimi Nr. 2/2010, 4 prill 2014 Liliane Gröninger 33

Komunikimi Nr. 4/2011, 9 shtator 2013 Zsolt Bujdosó,
Jánosné Ildikó Márkus, Viktória Márton, Sándor Mészáros,
Gergely Polk dhe János Szabó (përfaqësuar nga avokati,
János Fiala, Qendra për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar) 38

Komunikimi Nr. 8/2012 paraqitur nga: Z. X
(përfaqësuar nga avokati, Valeria G. Corbacho) 42

Komunikimi Nr. 30/2015 i paraqitur nga: Boris Makarov,
në emër të gruas së tij të ndjerë, Glafira Makarova 51

PJESA II:

GYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT 55

Rasti Glor kundër Zvicrës, 30.04.2009, Nr. 13444/04..... 55

Rasti Çam kundër Turqisë Aplikimi Nr. 51500/08, datë 23 Shkurt 2016..... 59

Guberina kundër Kroacisë Aplikimi Nr. 23682/13, datë 22.3.2016..... 64

HYRJJE

Kjo përmbledhje ka si qëllim promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë, dhe në veçanti të së drejtës për të mos u diskriminuar. Kjo përmbledhje botohet me qëllim që të vihet në dispozicion të profesionistëve të ndryshëm në fushën e drejtësisë, si dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë fushë, si: gjyqtarë, anëtarë të shoqërisë civile dhe të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, të institucioneve të ndryshme, të personave me aftësi të kufizuara dhe të tjerë të interesuar.

Kjo përmbledhje përmban vendimet dhe pikëpamjet e përzgjedhura për rastet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar të dy organeve ndërkombëtare, themelore për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara: të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është themeluar nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ai është organ i ekspertëve të pavarur dhe monitoron zbatimin e Konventës nga shtetet palë.

Të gjitha shtetet palë janë të detyruara t'i paraqesin Komitetit raporte të rregullta se si zbatohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet të raportojnë fillimisht brenda dy viteve që nga pranimi i Konventës dhe më pas çdo katër vjet. Komiteti shqyrton secilin raport dhe bën sugjerime e rekomandime të përgjithshme mbi raportin, ashtu si e vëren të përshtatshme, dhe ia përcjell ato shtetit palë në fjalë.

Protokolli Opsional i Konventës i jep Komitetit kompetencën për të shqyrtuar ankesat individuale në lidhje me pretendimet për shkelje të Konventës nga shtetet palë të Protokollit.

Jurisprudenca e Komitetit, ka pasur në mënyrë të konsiderueshme vitet e fundit, raste të diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara në lidhje me mohimin e aksesueshmërisë, të përshtatjeve të arsyeshme, të të drejtës së punësimit, të njohjes së barabartë para ligjit, të lirisë së shprehjes dhe mendimit, të të drejtës për të votuar, të të drejtës për jetë familjare etj.

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane është gjithashtu një mjet i rëndësishëm për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, por edhe për përqasjen e legjislacionit me parimet dhe nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe pse si rregull, nën parashikimet e Konventës, vetëm shteti i paditur me rastin konkret është i detyruar për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, nga praktikatat rezultojnë se disa prej shteteve anëtare në Konventë kanë ndryshuar ligjet ose praktikatat e tyre, duke u bazuar në vendimet e Gjykatës kundër shteteve të tjera, dhe se gjykatat vendase kanë marrë parasysh interpretimin e Konventës, siç është e shprehur vetë Gjykata në jurisprudencën e saj. Në këtë prizëm, kjo përmbledhje ka përzgjedhur vendimet e Gjykatës, me tematikën e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar. Edhe pse rezultojnë se ka një numër shumë të lartë ankesash për shkelje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara përmes diskriminimit, gjejmë një numër shumë të ulët vendimesh ku këto kërkesa në lidhje me diskriminimin janë marrë parasysh nga Gjykata. Edhe pse janë konstatuar shkelje të një morie të drejtash të personave me aftësi të kufizuara, sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut këto shkelje nuk kanë ndodhur si pasojë e diskriminimit.

Botimi është realizuar përmes grantit të mundësuar nga “Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

METODOLOGJIA

Për përgatitjen e kësaj përmbledhjeje është realizuar një kërkim i detajuar i rasteve të jurisprudencës së Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe i rasteve të diskriminimit në bazën e të dhënave të vëna në dispozicion nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara.

Ndërkohë, për çështjet e shqyrtuara nga Gjykata e Strasburgut, me fokusin në nenin 14 të KEDNJ (mosdiskriminimi) është zhvilluar një kërkim i detajuar në bazën e të dhënave të çështjeve të GJEDNJ-së, HUDOC-së.

Më tej, pas përzgjedhjes së çështjeve të diskriminimit, ato janë studiuar dhe analizuar me qëllim nxjerrjen e fakteve, të problemeve ligjore dhe të shkeljeve, si dhe vlerësimin e dy organeve, KDPAK dhe Gjykatës së Strasburgut.

PJESA I

KOMITETI PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Komunikimi Nr. CRPD / C / 20/D/35/2016: J.H.
(përfaqësuar nga këshilltarja, Michele Hardesty-Munday) kundër Australisë

Data e komunikimit: 12 shkurt 2016

Data e miratimit të pikëpamjeve: 31 gusht 2018

Subjekti: Kryerja e shërbimit të jurisë nga personat që nuk dëgjojnë

Çështjet e trajtuara në vendim: Barazia dhe mosdiskriminimi, përshtatja e arsyeshme, njohja e barabartë para ligjit, liria e shprehjes

Nezet e Konventës: 5 (2) dhe (3), 12 (2) dhe (3) dhe 21 (b) dhe (e); Artikulli i Protokollit Opsional: 2 (d) dhe (e)

Faktet e çështjes

J.H (ankimuese) është një shtetase australiane, e cila ka lindur me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe përdor gjuhën e shenjave australiane (Auslan) si gjuhën e saj amtare. Mes prillit dhe majit 2014, paditësja është thërritur nga Departamenti i Prokurorit të Përgjithshëm në Perth për të marrë pjesë në shërbimin e jurisë si anëtare¹ në Gjykatën e Qarkut të Australisë Perëndimore. Më 6 maj 2014, paditësja informoi Departamentin e Prokurorit të Përgjithshëm për rrethanat e saj dhe se ajo kërkonte një përkthyes në gjuhën e shenjave për ta lejuar atë të kryente detyrën e saj si anëtare jurie. Ajo gjithashtu informoi administratën që mbulonte shërbimet e jurisë se përkthyesit e gjuhës së shenjave mund të rezervoheshin përmes Shoqatës së Personave që nuk Dëgjojnë.

Administratori i shërbimeve të jurisë në Departamentin e Prokurorit të Përgjithshëm kontaktoi ankimuesen për ta pyetur nëse asaj i nevojitej përkthyes në gjuhën e

1. Në Australinë Perëndimore, anëtarët e jurisë përzgjidhen në mënyrë rastësore nga listat zgjedhore. Përzgjidhen afërsisht 12 deri në 18 persona, të cilët më pas betohen si anëtarë jurie për të gjykuar faktet e një çështjeje penale dhe për të dhënë një vendim. Shërbimi në juri konsiderohet në Australisi një përgjegjësi qytetare dhe një aspekt i rëndësishëm i administrimit të drejtësisë.

shenjave apo pajisje dëgjimi. Në të njëjtën ditë, ankimesja u përgjigj se kishte nevojë për një përkthyes pasi ajo nuk përdorte pajisje dëgjimi. Më 16 maj 2014, administratori njoftoi ankimesen se ajo do të përjashtohej nga thirrja për të shërbyer si anëtar jurie, sipas Ligjit për Jurinë të vitit 1957. Administratori deklaroi se duke pasur parasysh kërkesat e këtij ligji dhe nevojën thelbësore për një gjykim të drejtë ndaj të akuzuarit, duke përfshirë këtu ruajtjen e sekretit të diskutimeve mes anëtarëve të jurisë, gjykata nuk ishte në gjendje t'i siguronte asaj mjetet e nevojshme që ajo të shërbente në mënyrë efektive si anëtare jurie.

Ankimesja u përgjigj, duke shprehur pakënaqësinë e saj. Ajo theksoi se përdorimi i pajisjeve të dëgjimit në mënyrë të paqëllimtë mund të filtronte ose të fshinte informacionin e transmetuar. Bazuar në komunikimin me shkrim, ajo gjithashtu pohoi se nuk kishte asnjë problem për të kuptuar në gjuhën angleze dhe përjashtimi i saj nuk mund të justifikohej dhe se agjencitë shtetërore, duke përfshirë gjykatat e rrethit, kishin detyrim të siguronin përkthyes.

Në të njëjtën ditë, administratori u përgjigj përmes postës elektronike, duke deklaruar se vendimi i tij nuk kishte të bënte me pengesa financiare dhe se ai nuk e vërente ankimesen barrë për sistemin gjyqësor. Ai deklaroi se qëllimi kryesor i vendimit të tij ishte të siguronte një proces të drejtë ndaj të akuzuarit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në shkurt të vitit 2015, ankimesja paraqiti një ankesë, pranë Komisionerit të Shtetit për Mundësi të Barabarta. Komisioni e konsideroi kërkesën jashtë fushës së veprimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta.

Meqenëse Komisioni nuk mori në konsideratë ankesën, çështja e ankimeses nuk mund të paraqitej as në Gjykatën e Administratës Shtetërore sipas Aktit të Mundësive të Barabarta. Në lidhje me refuzimin, ankimesja thekson se neni 69 i Ligjit të Mundësive të Barabarta parashikon që asgjë në ligj nuk konsiderohet e jashtëligjshme, nëse është e nevojshme që personi të zbatojë një kërkesë të një ligji tjetër, i cili ndërkohë ishte në fuqi.

Ankimesja donte të paraqiste një ankesë sipas Ligjit për Diskriminimin për shkak të Aftësisë së Kufizuar 1992. Shterimi i këtij mjeti të brendshëm do të kishte qenë gjithashtu joefektiv në adresimin e ankesës së ankueses.

Shkeljet

Ankimuesja pretendon se shteti palë ka shkelur nenin 5 (2) dhe (3) të Konventës duke mos siguruar përshtatjen e arsyeshme për të parandaluar diskriminimin ndaj saj në bazë të aftësisë së kufizuar në dëgjim. Ankimuesja argumentoi se sigurimi i një përkthyesi të gjuhës së shenjave, i cili do të mundësonte që ajo të kryente shërbimin/detyrën në juri nuk është një barrë e shpërpjesëtuar ose e padrejtë. Ankimuesja më tej pretendon se megjithëse pajisjet për dëgjimin janë instaluar në sallat e gjykatës për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar në dëgjim, ato nuk janë i vetmi mjet për të siguruar aksesueshmërinë e plotë. Personat me aftësi të kufizuara në dëgjim kanë nevojë të mbështeten edhe me mënyra të kombinuara të leximit të buzëve, titra dhe shënime të shkruara për të kuptuar plotësisht çështjet.

Ankimuesja pretendon se shteti ka shkelur nenin 12 (2) dhe (3) të Konventës duke mos marrë masat e duhura për t'i siguruar asaj mbështetjen që i nevojitej për të kryer detyrën e saj si anëtare jurie. Ajo pretendon se e drejta e saj për të ushtruar zotësinë e plotë ligjore (kapacitetin ligjor sipas Konventës)² në kushte të barabarta me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës përfshin të drejtën për të qenë pjesë e një jurie të tillë. Ajo argumentoi se dështimi i shtetit palë për të siguruar një përkthyes, dhe fakti që ajo u përjashtua nga pjesëmarrja në juri pa marrë parasysh rrethanat e saj individuale, do të thotë që autoritetet vendase kanë një qasje të papërshtatshme në zbatimin e ligjit.

Ankimuesja pretendoi që edhe neni 21 i Konventës, liria e shprehjes dhe mendimit, është shkelur duke qenë se ajo u ndalua të mernte pjesë në juri pas dështimit për të siguruar një përkthyes.

Vlerësimi i komitetit

Komiteti në vlerësimin e tij rikujton se përkufizimi i diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar në nenin 2 të Konventës thotë shprehimisht, se: “Ai përfshin të gjitha format e diskriminimit, përfshirë mohimin e përshtatjes së arsyeshme”.

Përsa i përket përjashtimit nga detyra e jurisë sipas legjisllacionit vendas (u konsiderua që nuk ishte në gjendje të shërbente në mënyrë efektive si një anëtar jurie), Komiteti rikujton që diskriminimi mund të rezultojë nga efekti diskriminues i një rregulli ose mase që është

2. Pretendimi në lidhje me shkeljen e të drejtës së parashikuar në nenin 12, “Njohja e barabartë para ligjit” në lidhje me zotësinë për të vepruar, nuk u pranua nga komiteti.

neutral ose pa qëllim për të diskriminuar në dukje, por që prek në mënyrë të shpërpjesëtuar personat me aftësi të kufizuara. Sipas nenit 5 (2), shtetet palë duhet të ndalojnë të gjitha format e diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë e efektive kundër diskriminimit, dhe sipas nenit 5 (3), shtetet palë duhet të marrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar përshtatjen e arsyeshme për të promovuar barazinë dhe për të eliminuar diskriminimin.

Komiteti më tej rikujton se sipas nenit 2 të Konventës, “përshtatja e arsyeshme” nënkupton modifikimin dhe rregullimet e nevojshme dhe të përshtatshme që nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të padrejtë, kur është e nevojshme në një rast të veçantë, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin në një bazë të barabartë me të tjerët, për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore. Komiteti vëren që, kur vlerëson përshtatshmërinë dhe përpjesëtimërinë e masave, shtetet palë gëzojnë të drejtën për ta bërë këtë vlerësim në mënyra të ndryshme, por gjykatat e shteteve palë duhet të sigurojnë që vlerësimi të kryhet në mënyrë të plotë dhe objektive, duke mbuluar të gjitha elementet përkatëse, përpara se të arrijnë në përfundimin se masat e mbështetjes dhe përshtatjes përbëjnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të panevojshme.

Në rastin konkret, Komiteti vëren se rregullimet e bëra nga shteti palë për personat me aftësi të kufizuara në dëgjim nuk do të lejonin që ankimesja të mernte pjesë në një juri në kushte të barabarta me të tjerët. Në lidhje me argumentin e dhënë nga përfaqësuesit e shtetit palë, që sipas politikës dhe ligjit sigurohet përshtatje e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara në dëgjim përmes pajisjeve të dëgjimit në sallat e gjyqit, Komiteti vëren se kjo përshtatje nuk do t'i lejojë ankimeses të ketë akses të plotë në komunikimet gjatë shërbimit të saj. Komiteti gjithashtu vëren argumentin e shtetit palë se përdorimi i përkthyesve ka një ndikim në koston, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e gjyqimeve, duke pasqyruar gjetjet paraprake të një studimi në të cilin këto kosto janë dhënë në përgjithësi për një vit të plotë. Ndërkohë që shteti nuk ka arritur që të vlerësojë koston e një përshtatjeje të tillë në rastin individual ose ndonjë të dhënë tjetër për të justifikuar pretendimin se përshtatja e kërkuar është e shpërpjesëtuar ose përbën një barrë të tepruar në rrethanat specifike të çështjes. Në të njëjtën mënyrë, shteti nuk ka analizuar përshtatjen e kërkuar, sipas rëndësisë që ajo ka, përshtatshmërisë (të jetë e arsyeshme) dhe efektivitetit të saj. Në lidhje me këtë, Komiteti vëren se përkthimi është një përshtatje e zakonshme, i përdorur nga personat australianë me aftësi të kufizuara në jetën e tyre të përditshme dhe se ankimesja u tregoi autoriteteve të shtetit palë se si t'i rezervonin përkthyesit. Prandaj, Komiteti vëren se argumentet e shtetit palë nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se sigurimi i përkthyesit do të kishte rezultuar në një barrë të shpërpjesëtuar ose të panevojshme. Më tej, në lidhje me parimin e konfidencialitetit të diskutimeve që zhvillohen gjatë mbledhjeve të jurisë, shteti

nuk përmend rregullime të tilla, si për shembull: një betim të veçantë para gjykatës që mund të realizohet për t'u dhënë mundësi përkthyesve të kryejnë funksionet e tyre pa cenuar këtë parim. Komiteti vëren se shteti palë nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar përshtatje të arsyeshme dhe arrin në përfundimin se refuzimi për të siguruar shërbimin e përkthimit në gjuhën e shenjave, pa vlerësuar plotësisht nëse kjo do të përbente një barrë të shpërpjesëtuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në shkelje të të drejtave të ankimueses, sipas nenit 5 (2) dhe (3) të Konventës.

Për sa i përket shkeljes së nenit 21, Komiteti vëren argumentin e shtetit palë se kjo dispozitë nuk ka të bëjë me faktet e çështjes, pasi nuk mbulon të drejtën për të qenë pjesë e një jurie, duke pasur parasysh që pjesëmarrja në juri nuk përbën komunikim zyrtar, sipas nenit 21 (b) të Konventës. Në lidhje me këtë, Komiteti rikujton që, në përputhje me nenin 21 (b) të Konventës, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mund të ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit, përfshirë lirinë e kërkimit, marrjen dhe dhënien e informacioneve dhe ideve në kushte të barabarta me të tjerët dhe përmes të gjitha formave të komunikimit, duke pranuar dhe lehtësuar përdorimin e të gjitha mjeteve, mënyrave dhe formateve të komunikimit të arritshme nga personat me aftësi të kufizuara në komunikimet zyrtare. Për më tepër, neni 21 (e) i Konventës përcakton që masa të tilla të përshtatshme përfshijnë njohjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhëve të shenjave. Komiteti më tej rikujton se, sipas nenit 2 të Konventës, “komunikimi” përfshin gjuhët dhe mënyrat alternative, mjetet dhe formatet e komunikimit, duke përfshirë qartë përkthimin. Në këtë kontekst, Komiteti është i mendimit se anëtari i jurisë është një person që mban një përgjegjësi publike në administrimin e drejtësisë në bashkëveprim me të tjerët, përfshirë anëtarët e tjerë dhe zyrtarët gjyqësorë, dhe se një ndërveprim i tillë përbën “ndërveprim zyrtar” brenda kuptimit të nenit 21. Në këtë kuptim, Komiteti vëren se refuzimi për t'i dhënë ankimueses formatin e komunikimit që i nevojitej për të kryer detyrën si anëtare jurie, pra për t'u shprehur në ndërveprimet zyrtare, përbën një shkelje të nenit 21 (b) dhe (e) të Konventës.

Rekomandimet e komitetit:

- Shteti duhet t'i sigurojë ankimueses një mjet efektiv juridik, përfshirë rimbursimin e çdo kostoje ligjore të përballuar prej saj në këtë komunikim dhe gjithashtu kompensimin.
- Shteti duhet t'i mundësojë pjesëmarrjen në juri, duke i siguruar asaj përshtatje të arsyeshme në formën e përkthimit në gjuhën e shenjave në një mënyrë që

respekton konfidencialitetin e procedurat në të gjitha fazat e përzgjedhjes në juri dhe gjatë procedurave gjyqësore.

Në përgjithësi, shteti (Australia) është i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen. Në këtë drejtim, Komiteti kërkon që shteti:

- Të sigurojë që sa herë që një person me aftësi të kufizuara thirret për të kryer detyrën si anëtar jurie, të kryhet një vlerësim i plotë, objektiv dhe gjithëpërfshirës i kërkesës për rregullimet dhe të gjitha përshtatjet e arsyeshme duhet të sigurohen për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë;
- Të miratojë ndryshimet e nevojshme në ligjet, rregulloret, politikat dhe programet përkatëse, në konsultim të ngushtë me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese;
- Të sigurojë trajnimin e duhur dhe sistematik mbi Konventën dhe Protokollin Opsional për autoritetet lokale dhe oficerët gjyqësorë dhe administratës së gjyqësorit, sikurse janë edhe shërbimet për juritë, duke përfshirë aksesin për personat me aftësi të kufizuara.

Komunikimi Nr. 39/2017: Luliia Domina dhe Max Bendtsen (përfaqësuar nga avokati, Eddie Kawaja) kundër Danimarkës

Data e komunikimit: 6 janar 2017 (dorëzimi fillestar)

Data e miratimit të pikëpamjeve: 31 Gusht 2018

Subjekti: Bashkimi familjar

Çështjet e trajtuara: Respektimi i shtëpisë dhe familjes; diskriminimi i bazuar në paaftësi.

Nenet e Konventës: 5 dhe 23; neni i Protokollit Opsional: 2 (e).

Faktet e çështjes

Ankimuesit janë Luliia Domina, shtetase ukrainase dhe Max Bendtsen, shtetas danez, të dy të lindur më 1989. Ankimuesit janë një çift i martuar dhe kanë një djalë të lindur në vitin 2015. Z. Bendtsen ka dëmtim të trurit si rezultat i një aksidenti automobilistik në vitin 2009. Kërkesa e tyre për bashkim familjar në Danimarkë dhe leja e qëndrimit për znj. Domina është mohuar nga autoritetet vendase. Ankimuesit pretendojnë se refuzimi i kërkesës së tyre për bashkim familjar përbën shkelje të të drejtave të tyre, sipas neneve 5 dhe 23 të KDPAK-së.

Më 9 janar 2017, raportuesi special për komunikimet e reja dhe masat e përkohshme, në emër të Komitetit, miratoi një kërkesë për vendosjen e një mase sigurie të përkohshme, sipas nenit 4 të Protokollit Opsional, për mosdëbimin nga Danimarka të znj. Domina në Ukrainë, ndërsa çështja shqyrtohej nga Komiteti. Më 11 Janar 2017, Bordi i Apelit të Emigracionit pezulloi afatin e largimit për znj. Domina nga Danimarka deri në një njoftim të dytë.

Më 30 maj 2013, ankimuesit kërkuan bashkimin familjar dhe leje qëndrimi për znj. Domina në shtetin danez bazuar në lidhjen e tyre martesore, të bërë më 13 prill 2013. Dokumentacioni dhe informacioni rreth shëndetit fizik dhe mendor të z. Bendtsen u përfshi në aplikimin e paraqitur tek autoritetet e emigracionit. Informacioni evidentonte faktin se në vitin 2009 z. Bendtsen kishte pësuar një aksident të rëndë automobilistik, i cili e kishte lënë atë me dëmtime të përhershme të trurit dhe se, mbi atë bazë që nga maji i vitit 2009, ai kishte përfituar pagesa nga skema sociale, pasi nuk mund të punonte. Kërkesa e ankimuesve u refuzua më 29 gusht 2013 nga Shërbimi i Imigracionit me argumentimin sez. Bendtsen kishte përfituar nga skema sociale për një periudhë tre vjeçare para datës në të cilën do të mund t'i akordohej bashkimi familjar. Vendimi u mor nga autoritetet bazuar në nenin 9 (5) të Ligjit për të Huajt, sipas të cilit nuk mund të jepet një leje qëndrimi për bashkim familjar pasi bashkëshorti i aplikantes kishte përfituar për një periudhë tre vjeçare para aplikimit. Vendimi u la në fuqi nga Bordi i Apelit të Emigracionit.

Çështja u dërgua në gjykatë dhe Gjykata e Lartë Lindore mori vendimin se vendimi i Bordit të Apelit të Emigracionit kishte shkelur Konventën, duke vërejtur se kriteri që bashkëshorti të kishte të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten, nuk mund të aplikohet në këtë rast nëse sipas Konventës, duhet të hiqet dorë nga ky kriter. Ky do të ishte rasti nëse personi nuk mund të përmbushte kërkesat financiare për shkak të aftësisë së kufizuar. Gjykata më tej vuri në dukje se z. Bendtsen i ishte ofruar një pension i parakohshëm për shkak të aftësisë së kufizuar dhe se ai do të përjashtohej nga kriteri financiar, nëse e pranonte ofertën. Në bazë të vlerësimit të gjendjes shëndetësore të z. Bendtsen, ai nuk kishte asnjë mundësi që ta mbante veten financiarisht. Prandaj, gjykata arriti në përfundimin se z. Bendtsen, në bazë të aftësisë së tij të kufizuar, nuk duhet t'i kërkohej që të përmbushë kërkesën për të qenë i aftë financiarisht, pasi kjo kërkesë do ta pengonte atë të gëzonte të drejtën e tij për jetë familjare në kushte të barabarta me personat e tjerë.

Në apel, në një vendim të 22 dhjetorit të vitit 2016, Gjykata e Lartë rrëzoi vendimin e Gjykatës së Lartë Lindore, duke theksuar se z. Bendtsen kishte marrë pjesë në një program për të vlerësuar opsionet e tij në lidhje me punësimin dhe arsimin, dhe ishte i aftë të punonte në kushte të caktuara. Bazuar në këtë, Gjykata e Lartë arriti

në përfundimin se z. Bendtsen kishte mundësi për të përmbushur kërkesën për të qenë në gjendje të mbështeste veten financiarisht. Ajo gjithashtu arriti në përfundimin se ai ishte në një pozicion të krahasueshëm me persona pa aftësi të kufizuara që gjithashtu kishin përfituar pagesa nga skema sociale, dhe se për këtë arsye ai nuk kishte qenë subjekt i diskriminimit në shkelje të Konventës dhe të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj).

Shkeljet

Ankimuesit vërejnë se sipas paragrafit 9 (5) të Ligjit për të Huajt, dhënia e një lejeje qëndrimi për një aplikant të martuar me një shtetas danez është e kushtëzuar nga fakti që bashkëshorti/ja që jeton në Danimarkë duhet të mos ketë marrë përfitime sociale brenda një periudhe prej tre vjetësh para aplikimit. Ankimuesit pretendojnë se kjo politikë shkel të drejtat e tyre, sipas neneve 5 dhe 23 të Konventës. Ata argumentojnë se përkufizimi i diskriminimit që zbatojnë autoritetet daneze është i pasaktë pasi nuk përmban detyrimin për të siguruar përshtatje të arsyeshme dhe gjithashtu nuk siguron mbrojtje ndaj diskriminimit të tërthortë për shkak të aftësisë së kufizuar. Ata argumentojnë se Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se z. Bendtsen mernte pagesa për shkak të aftësisë së tij të kufizuar, por nuk mori parasysh që personat me aftësi të kufizuara ishin në një situatë dukshëm të ndryshme nga të tjerët për sa i përket mundësive dhe aksesit në tregun e punës. Prandaj z. Bendtsen u vendos në një disavantazh të paarsyeshëm në bazë të aftësisë së tij të kufizuar. Ankimuesit argumentojnë se kriteri financiar që kushtëzon bashkimin familjar përbën një pengesë për personat me aftësi të kufizuara për të gëzuar të drejtën për jetën familjare në një bazë të barabartë me personat pa aftësi të kufizuara.

Ankimuesit më tej theksojnë se fëmija i tyre i vogël është plotësisht i varur nga znj. Domina, pasiz. Bendtsen, për shkak të aftësisë së tij të kufizuar, nuk është në gjendje të kujdeset për të pa ndihmë. Dëbimi i znj. Domina në Ukrainë do të dëmtonte në mënyrë të pariparueshme familjen e tyre.

Vlerësimi i Komitetit

Komiteti rikujton që sipas nenit 2 të Konventës, “diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar” përcaktohet si çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë të aftësisë së kufizuar që ka për qëllim ose efekt të dëmtojë ose anulojë njohjen, gëzimin ose

ushtrimin, në një bazë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në ndonjë fushë tjetër, dhe përfshin të gjitha format e diskriminimit, përfshirë mohimin e përshtatjes së arsyeshme.

Komiteti më tej rikujton se një ligj që zbatohet në një mënyrë neutrale mund të ketë efekt diskriminues kur nuk merren parasysh rrethanat e veçanta të individëve për të cilët zbatohet. E drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës mund të shkelet kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk arrijnë të trajtojnë ndryshe personat, situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme. Komiteti rikujton se në rastet e diskriminimit të tërthortë, ligjet, politikat ose praktikat neutrale kanë një ndikim negativ në mënyrë të shpërpjesëtuar te personat me aftësi të kufizuara. Diskriminimi i tërthortë ndodh kur një mundësi që duket e arritshme, në të vërtetë përjashton persona të caktuar për shkak të faktit se statusi i tyre nuk i lejon ata të përfitojnë nga vetë mundësia.

Komiteti vëren se diskriminimi i tërthortë ndodh kur efektet e dëmshme të një rregulli ose vendimi prekin ekskluzivisht, ose në mënyrë të shpërpjesëtuar personat e një race të caktuar, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, politike ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, prone, apo statusi tjetër. Të pasurit e një aftësie të kufizuar përfshihen në kategori të tilla. Komiteti më tej vëren se sipas nenit 5 (1) dhe (2) të Konventës, shtetet palë kanë detyrime të pranojnë që të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa asnjë diskriminim për mbrojtjen e barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji; të ndalojnë çdo diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit.

Në rastin konkret, kërkesa e ankimesve për bashkim familjar u refuzua pasi z. Bendtsen nuk plotësoi kriterin sipas paragrafit 9 (5) të Ligjit për të Huajt për të mos pasur përfitime nga skema sociale për një periudhë trevjeçare para aplikimit. Z. Bendtsen morri përfitime sipas Ligjit të Politikës Sociale nga 14 maj 2009 dhe vazhdoi t'i merrte deri në mes të tetorit 2015, ndërkohë që ai ishte i punësuar në kuadër të programit të subvencionimit të pagave. Komiteti vëren se është e padiskutueshme që ankimesi i ka marrë pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komiteti shqyrton argumentin e shtetit se ekzistenca e një aftësie të kufizuar nuk mund të shihet e veçuar dhe të përbëjë përjashtim nga kushti i përcaktuar në nenin 9 (5) të Ligjit për të Huajt, pasi vlerësimi përkatës duhet të niset nga fakti nëse aftësia e kufizuar parandalon një person të punësohet në një moment të mëvonshëm dhe në përputhje me rrethanat, si dhe të përmbushë kushtin në ligj. Komiteti gjithashtu

analizoi argumentin e shtetit se Gjykata e Lartë dhe Bordi i Apelimit të Emigracionit zbuluan se z. Bendtsen kishte mundësi për të përmbushur kriterin financiar sipas nenit 9 (5) të Ligjit për të Huajt për shkak të mundësisë së tij për të gjetur një punë përmes programit të subvencionimit të pagave. Komiteti më tej shqyrton argumentin e ankimesve se vlerësimi përkatës për të përcaktuar nëse z. Bendtsen ishte diskriminuar për shkak të aftësisë së tij të kufizuar është lidhja mes faktit që ai ka pasur pagesa për shkak të aftësisë së tij të kufizuar dhe refuzimit të kërkesës për bashkim familjar në bazë të këtyre pagesave.

Në rastin konkret, Komiteti vëren se në kohën e aplikimit të ankimesve për bashkim familjar, z. Bendtsen merrte pagesa për shkak të aftësisë së tij të kufizuar dhe ai nuk ishte në gjendje të punonte. Komiteti vëren se autoritetet vendase refuzuan kërkesën e ankimesve për bashkim familjar pasi arritën në përfundimin se z. Bendtsen kishte një mundësi reale për të përmbushur kriterin financiar për të mbajtur veten sipas nenit 9 (5) të Ligjit për të Huajt për shkak të mundësisë së tij për të gjetur një punë nën programin e subvencionimit të pagave. Ai gjithashtu thekson që kur ankimesit bënë kërkesën e tyre për bashkim familjar, z. Bendtsen nuk ishte kualifikuar ende për programin e subvencionimit të pagave dhe për këtë arsye nuk mund të përmbushte kërkesën për bashkim familjar, sipas Ligjit për të Huajt.

Në atë kohë, bashkimi familjar ishte përparësi për ankimesit dhe djalin e tyre. Vlerësimi nëse z. Bendtsen mund të kualifikohej për punësim në kuadër të programit të subvencionimit të pagave nuk ishte finalizuar deri në mars të vitit 2015 dhe ai nuk ishte i punësuar në bazë të programit deri në tetor të vitit 2015, gjashtë vjet pasi ai kishte filluar të merrte pagesat sociale dhe dy vjet e gjysmë pasi ankimesit kishin paraqitur kërkesën e tyre për bashkim familjar. Komiteti më tej vëren pretendimin e padiskutueshëm të ankimesve se për të përmbushur kërkesën sipas Ligjit për të Huajt pasi z. Bendtsen të ishte kualifikuar për programin e subvencionimit të pagave në tetor të vitit 2015, ata do të përballëshin me një periudhë shtesë pritjeje prej tre vitesh para se t'i lindte e drejta për bashkim familjar sipas ligjit. Prandaj Komiteti arrin në përfundimin se në këtë rast kriteri financiar që duhej plotësuar sipas nenit 9 (5) të Ligjit për të Huajt ndikoi në mënyrë të shpërpjesëtuar tek z. Bendtsen si një person me aftësi të kufizuar dhe rezultoi në një diskriminim të tërthortë.

Komiteti, pra, konstaton se autoritetet përkatëse vendase refuzuan kërkesën e ankimesve për bashkim familjar në bazë të kriterëve që ishin tërthorazi diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe kjo pati si efekt cënimin ose mohimin e të drejtës për të jetë familjare në kushte të barabarta me të tjerët sipas nenit 5 (1) dhe (2), veçmas dhe në lidhje me nenin 23 (1) të Konventës.

Rekomandimet e Komitetit

- Ankimuesve duhet t'u sigurohet një mjet efektiv juridik, përfshirë kompensimin për çdo kosto ligjore për këtë komunikim.
- Të ndalohet deportimi i znj. Domina në Ukrainë dhe të respektohet e drejta për jetën familjare në Danimarkë.
- Të publikohet ky vendim (rekomandim) dhe në formate të arritshme në mënyrë që të njihet nga publiku i gjerë.
- Në përgjithësi, shteti është i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen.
- Në këtë drejtim, Komiteti i kërkon shtetit palë të sigurojë që pengesat në gëzimin e të drejtës për jetë familjare nga personat me aftësi të kufizuara në kushte të barabarta me të tjerët të eliminohen në legjislacionin kombëtar.

Komunikimi Nr. 23/2014, Y kundër Republikës së Bashkuar të Tanzanisë

Data e komunikimit: 23 qershor 2014 (dorëzimi fillestar)

Data e miratimit të pamjeve: 31 Gusht 2018

Subjekti: Tortura, trajtimi çnjerëzor dhe degradues; diskriminim ndaj një personi me albinizëm.

Çështjet e trajtuara: albinizmi; diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar; tortura, trajtimi çnjerëzor dhe degradues; shkelja e të drejtës për respekt të integritetit intelektual dhe mendor.

Nenet: 1, 4, 5, 7, 8, 14, 15, 16, 17 dhe 24; Neni 2 i Protokollit Opsional.

Faktet e çështjes

Ankimuesi ka lindur në vitin 1999. Ai është nga Nyaruguguna, një fshat në rajonin Geita të Republikës së Bashkuar të Tanzanisë. Ai dhe vëllai i tij janë me albinizëm. Si pasojë e këtij fakti, familja e tyre i ka braktisur. Që nga ajo kohë, një organizatë jofitim prurëse (OJF) kujdeset për ta.

Në vitin 2008, për shkak të përshkallëzimit të vrasjeve dhe dhunës ndaj personave me albinizëm, ankimuesi dhe vëllai i tij kishin frikë se mos vriteshin dhe për këtë arsye

braktisën shkollën fillore, e cila ishte larg shtëpisë së tyre duke i detyruar ata që të bënin një rrugë të gjatë, gjatë së cilës ishin pre e sulmeve lehtësisht.

Në vitin 2010, kur ankimesi ishte vetëm 11 vjeç, një fqinj i rroi me forcë flokët. Çështja nuk u hetua ndonjëherë, ndërsa fqinji nuk u procedua kurrë.

Më 14 tetor 2011, kur ishte 12 vjeç, ai u sulmua nga një burrë me hanxhar, i cili i preu tre gishta të dorës së tij të djathtë. Agresori gjithashtu e theri në shpatullën e majtë, duke e lënë atë me aftësi të kufizuar fizike. Ankimesi u largua nga agresori pasi i kafshoi atij organet gjenitale. Ngjarja ndodhi para shtëpisë së tij. Atij nuk iu dha asnjë ndihmë mjekësore ose rehabilitim. Më vonë, në vitin 2012, OJF-ja e ktheu ankimesin në shkollë. Sidoqoftë, prej mungesës së gjatë në shkollë, ai është përballur me vështirësi të mëdha dhe ende nuk është në gjendje të lexojë apo të shkruajë siç duhet. Shteti nisi një hetim për veprën penale të ndodhur. Më 15 tetor të vitit 2011, bazuar në dëshminë e ankimesit dhe të disa fqinjëve të tij, tre persona u arrestuan dhe u dërguan në gjykatë: R.T., babai biologjik, A.M., njerka e tij, dhe M.A., xhaxhai i tij. Më 16 tetor të vitit 2011, ata u akuzuan për vrasje të mbetur në tentativë dhe për ushtrim dhune.

Në qershor të vitit 2012, prokuroria hoqi dorë nga akuzat për mungesë provash. Në lidhje me këtë, autori vëren se vetëm 5 nga 72 vrasjet e personave me albinizëm të dokumentuara që nga viti 2000 në Republikën e Bashkuar të Tanzanisë kanë shqyrtuar në mënyrë të suksesshme. Në shumicën e rasteve, autorët nuk janë hetuar dhe ndjekur penalisht për shkak të mungesës së provave. Në këtë mënyrë, ka nxitur një kulturë mosdëshkimi dhe janë inkurajuar përndjekjet, diskriminimi dhe vrasjet e personave me albinizëm.

Sipas statistikave të dhëna nga ankimesi, numri i personave me albinizëm në Republikën e Bashkuar të Tanzanisë vlerësohet të jetë më shumë se 200000. Ai pretendon se personat me albinizëm vuajnë nga forma të ndryshme persekutimi dhe diskriminimi, shumë prej të cilave janë të bazuara në mite me rrënjë të thella. Ankimesi u sulmua për shkak të besimit se pjesët e trupit të një personi me albinizëm sigurojnë pasuri dhe prosperitet. Ky besim është i përhapur në Republikën e Bashkuar të Tanzanisë dhe ka çuar në rritjen e persekutimit të personave me albinizëm dhe krijimin e një tregu të zi me pjesë të trupit të personave të tillë. Fëmijët gjithnjë e më shumë po vihen në shënjestër, pasi besohet se ata kanë shpirt të pafajshëm dhe se pjesët e trupit të tyre kanë fuqi më të fortë magjike për të sjellë pasuri. Ndër sulmet e raportuara në vitet 2011 dhe 2012, shtatë ishin fëmijë, më i vogli shtatë muajsh. Autori pohon se jeta dhe integriteti fizik i personave me albinizëm janë në rrezik të përhershëm në Republikën e Bashkuar të Tanzanisë.

Shkeljet

Ankimuesi pretendon se shteti ka shkelur të drejtat e tij sipas neneve 4, 5, 7, 8, 14, 15, 16, 17 dhe 24 të Konventës. Ai pretendon se shteti nuk ka arritur t'i sigurojë atij mbrojtjen që i duhej si fëmijë me albinizëm, dhe për këtë arsye e ka vënë atë në një rrezik të përhershëm. Këto praktika janë të njohura nga shteti, por ai nuk ndërmerr ndonjë veprim për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë me albinizëm të cilët janë në një situatë me ndjeshmëri shumë të lartë. Prandaj, ankimuesi argumenton se mungesa e ndërhyrjes së shtetit në rastin e tij përbën shkelje të nenit 4 të Konventës.

Ankimuesi gjithashtu pretendon që shteti nuk ka ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që personat me albinizëm nuk diskriminohen në bazë të aftësisë së kufizuar. Ai pohon se fëmijët me albinizëm që jetojnë në Republikën e Bashkuar të Tanzanisë, pësojnë poshtërime, fyerje dhe marginalizim. Dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive çështjen e tij dhe raste të ngjashme, dhe për të ndjekur penalisht autorët, përbën një shkelje të të drejtave të tij për barazi dhe mosdiskriminim, në kundërshtim me nenin 5 (2) dhe (3) të Konventës.

Ankimuesi argumenton se shteti palë nuk ka arritur të krijojë një mjedis të sigurt pasi nuk ka siguruar që personat me albinizëm të mbrohen nga sulmet, dhuna, kërcënimet dhe çdo formë tjetër e kërcënimeve. Shteti palë i ka lënë personat me albinizëm në mëshirën e kujtëdo që dëshiron të "gjuajë" pjesët e trupit të tyre. Në rastin e tij, si një fëmijë me albinizëm, ankimuesi deklaron që shteti palë nuk ka përmbushur detyrimet e tij për të siguruar dhe mbrojtur dinjitetin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke shkelur kështu nenin 7 të Konventës.

Ankimuesi pretendon se shteti nuk ka marrë masat e duhura për të rritur ndërgjegjësimin në të gjithë shoqërinë në lidhje me personat me albinizëm. Për më tepër, shteti nuk i ka siguruar atij ndihmë mjekësore ose rehabilitim. Prandaj, ai vëren se shteti palë ka shkelur nenin 8 të Konventës.

Ankimuesi argumenton se rreziku i përhershëm me të cilin po përballet, dhe ndaj të cilit shteti palë nuk ka marrë asnjë masë, e ka detyruar atë të braktisë shkollën për dy vite dhe për këtë arsye i ka mohuar atij të drejtën e tij për arsimim. Ai vëren se kjo përbën shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 24 (1) të Konventës.

Ai gjithashtu argumenton se dështimi nga ana e shtetit për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të sjellë para drejtësisë autorët e sulmeve që ai pësoi në vitin 2010 ka shkelur të drejtën e tij për akses në drejtësi. Prandaj, ai vëren se shteti palë ka shkelur nenin 13 të Konventës.

Për më tepër, ankimesi vëren se shteti nuk ka arritur ta mbrojë atë nga dhuna dhe torturat. Autoritetet, edhe pse në dijeni të këtyre ngjarjeve, nuk kanë marrë masat e duhura për të kufizuar abuzimet fizike, emocionale dhe psikologjike. Kjo situatë vazhdon edhe pse Këshilli i të Drejtave të Njeriut i bëri thirrje Tanzanisë në vitin 2013 të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të personave me albinizëm dhe të familjarëve të tyre. Ankimesi i vëren sulmet që pësoi si pasojë të drejtpërdrejtë të mungesës së ndërhyrjes nga autoritetet, të cilat, së bashku me dështimin e tyre për të hetuar sulmet që ai pësoi, përbëjnë një shkelje të neneve 15 dhe 16 të Konventës.

Ai gjithashtu pretendon se, si rezultat, integriteti i tij fizik dhe mendor është cenuar dhe se autoritetet e shtetit palë kanë shkelur detyrimet e tyre sipas nenit 17 të Konventës.

Ankimesi gjithashtu deklaroi se ka bërë përpjekje për të shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme të disponueshme. Megjithatë këtë, shteti nuk ka arritur të kryejë hetime efektive mbi sulmet që ai pësoi në vitet 2010 dhe 2011, sulme të cilat ai i raportoi në polici. Ai kujton se në qershor të vitit 2012 prokuroria vendosi të heqë akuzat kundër tre të dyshuarve, për mungesë të provave. Autori gjithashtu deklaroi se Kodi i Procedurës Penale parashikon që një viktimë nuk është në gjendje të fillojë një ndjekje penale para një gjykate.

Vlerësimi i Komitetit

Komiteti thekson që sipas nenit 5 (1), (3) të Konventës, shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga diskriminimi, si dhe duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhur për të siguruar përshtatjen e arsyeshme në mënyrë që të promovojnë barazinë dhe të eliminojnë diskriminimin. Në rastin konkret, Komiteti vëren se ankimesi ishte viktimë e një krimi të dhunshëm që përputhet me karakteristikat e një praktike që prek ekskluzivisht personat me albinizëm.

Komiteti vëren se shteti nuk mund të shmangë përgjegjësitë e tij sipas Konventës për faktin e thjeshtë se disa prej autoriteteve të tij, të tilla si gjykatat, tashmë janë marrë ose janë duke u marrë me këtë çështje, ndërsa është e qartë se proceset janë pezulluar ose janë zgjatur padrejtësisht dhe duken të jenë joefektive. Ai gjithashtu vëren se dështimi i shtetit për të parandaluar dhe ndëshkuar akte të tilla e ka vendosur ankimesin dhe personat e tjerë me albinizëm në një situatë ndjeshmërie të veçantë që i pengon ata të jetojnë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Në mungesë

të ndonjë shpjegimi nga shteti për këto çështje, Komiteti arrin në përfundimin së ankimesi ka qenë viktimë e një forme dhune që synon ekskluzivisht personat me albinizëm. Prandaj Komiteti vëren se autori ka qenë viktimë e një diskriminimi të drejtpërdrejtë bazuar në aftësinë e tij të kufizuar, në kundërshtim me nenin 5 të Konventës.

Gjithashtu, Komiteti rikujton se, sipas nenit 7(1) të Konventës, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar gëzimin e plotë nga fëmijët me aftësi të kufizuara të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Komiteti vëren se duke mos siguruar mbrojtje ndaj ankimesit, një fëmijë 12-vjeçar, përkundër ankesës që ai kishte paraqitur në polici pas sulmit të parë, dhe dështimin për t'i siguruar atij ndihmën mjekësore dhe rehabilitim, shteti ka shkelur detyrimet e tij sipas nenit 7 të Konventës.

Lidhur me pretendimet e ankimesit mbi nenin 8 të Konventës, Komiteti vëren se shteti nuk arriti të marrë masat e duhura dhe të përshtatshme për të rritur ndërgjegjësimin në të gjithë shoqërinë, e cila çoi në diskriminim dhe pasiguri për personat me albinizëm, dhe se ai nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për t'i dhënë fund kësaj situatë. Komiteti vëren se pasiviteti i shtetit përbën një pranim të nënkuptuar të vazhdimit të krimeve të tmerrshme të kryera në juridiksionin e tij kundër personave me albinizëm dhe vëren se kjo përbën shkelje të nenit 8 të Konventës.

Në lidhje me nenin 15, Komiteti thekson se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturave ose trajtimit, ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor, ose poshtëruës dhe se shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat efektive legjislative, administrative, gjyqësore ose të tjera për të parandaluar personat me aftësi të kufizuar, në kushte të barabarta me të tjerët, nga të qenit i nënshtruar ndaj torturës ose trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose degradues. Komiteti thekson se veprimet e dhunshme të pësuara nga autori janë kryer nga individë privatë, dhe se, si të tilla, ato nuk përbëjnë akte të torturës. Sidoqoftë, Komiteti gjithashtu kujton se detyrimi i shteteve palë për të parandaluar dhe ndëshkuar torturat dhe shkeljet e trajtimit çnjerëzor dhe degradues zbatohet për veprimet e kryera nga aktorët shtetërorë dhe joshetërorë. Hetimi efektiv është veçanërisht i rëndësishëm në gjykimin e çështjeve të tilla. Komiteti gjithashtu vëren se vuajtjet e përjetuara nga ankimesi, për shkak të mungesës së veprimeve nga shteti për të lejuar ndjekjen efektive të autorëve të dyshuar të krimit, bëhen shkak i ringjalljes së kujtimeve dhe përbëjnë tortura psikologjike dhe/ose sëmundje. Për këto arsye, Komiteti konstaton se, në rrethanat e çështjes në fjalë, shteti ka shkelur nenin 15 të Konventës.

Komiteti thekson se, sipas nenit 16(4) të Konventës, shtetet palë duhet “të marrin

të gjitha masat e duhura për të nxitur, rehabilitimin dhe riintegrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara që bëhen viktimat të çdo forme shfrytëzimi dhune ose abuzimi, përfshirë përmes ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes”, dhe se rikuperimi dhe riintegrimi i tillë duhet “të ndodhë në një mjedis që nxit shëndetin, mirëqenien, vetërespektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh gjininë dhe nevojat specifike të moshës”. Në mungesë të ndonjë përgjigjeje nga shteti në lidhje me pretendimet e autorit për shkelje të nenit 16, Komiteti vëren se edhe pse, në kohën e sulmit, ankimuesi ishte një fëmijë 12-vjeçar, i cili ishte braktisur nga familja, shteti nuk arriti t’i sigurojë atij asnjë lloj kujdesi mjekësor dhe ndihmë për rehabilitimin e tij. Për këto arsye, Komiteti gjen se, në rrethanat e çështjes, shteti ka shkelur nenin 16 të Konventës.

Në lidhje me ankesën e autorit, sipas nenit 17 të Konventës, Komiteti thekson se sipas këtij neni, “çdo person me aftësi të kufizuara ka të drejtë të respektojë integritetin e tij fizik dhe mendor mbi baza të barabartë me të tjerët”. Ai gjithashtu kujton se “e drejta për integritet të personit bazohet në atë që do të thotë të jesh person”. Ajo është e lidhur me idenë e dinjitetit njerëzor dhe që hapësira fizike dhe mendore e secilit person duhet të mbrohet. Gjithashtu përfshin ndalimin e torturave fizike dhe mendore, dhe të trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtërues, si dhe të një game të gjerë të formave më pak serioze të ndërhyrjeve në trupin dhe mendjen e një personi. Aktet e dhunshme që ka pësuar ankimuesi futen qartë në kategorinë e akteve që rezultojnë sishkelje të integritetit fizik dhe mendor, pasi praktika aktuale në shtetin palë konsiston në gjuetinë e personave me albinizëm, me qëllimin për të prerë disa nga pjesët e trupit të tyre, duke u mohuar atyre integritetin e tyre fizik. Komiteti gjithashtu kujton se, sipas Nenit 4 të Konventës, Shtetet Palë kanë detyrimin e përgjithshëm të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar dhe promovuar realizimin e plotë të kësaj të drejte. Në rastin konkret, shteti palë nuk ndërmori ndonjë masë për të parandaluar veprimet e pësuarat nga ankimuesi, nuk arriti të ndjekë penalisht autorët e veprimeve dhe nuk mori asnjë masë për t’i siguruar ankimuesit rehabilitim ose mbështetje për riintegrimin e tij në shoqëri. Deri më tani, krimet e kryera mbeten të pandëshkuara. Komiteti gjithashtu vëren se ankimuesit nuk i është siguruar ndonjë mbështetje nga autoritetet e shtetit palë për t’i mundësuar një jetesë të pavarur pas humbjes së krahut të majtë dhe dorës së djathtë dhe se, në përgjithësi, shteti nuk ka miratuar ndonjë masë për të parandaluar këtë formë të dhunës ndaj personave me albinizëm. Si pasojë, Komiteti vëren se dështimi nga shteti për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar akte dhune të ngjashme me ato të pësuarat nga ankimuesi dhe për të hetuar dhe ndëshkuar në mënyrë efektive autorët e këtyre veprimeve në çështjen e tij përbën shkelje të nenit 17, së bashku me nenin 4 të Konventës.

Komiteti vëren pretendimet e autorit për shkelje të nenit 24 të Konventës për dëshkrimin nga shteti për ta mbrojtur atë nga një klimë e përgjithshme dhune në rritje dhe sulmet kundër personave me albinizëm, të cilat e detyruan atë të braktiste shkollën për dy vjet. Komiteti gjithashtu vë në dukje pretendimin e ankimesit se, si pasojë e këtyre dy viteve pa arsim, ai ka vështirësi të lexojë dhe të shkruajë siç duhet. Në mungesë të ndonjë parashtrimi nga shteti palë për këtë pikë, Komiteti vëren se shteti palë nuk i dha autorit ndonjë ndihmë dhe nuk miratoi asnjë formë përshtatjeje të arsyeshme për të mundësuar që ai të shkonte në shkollë, dhe se si pasojë ai u privua nga e drejta e tij për arsimim, derisa një OJF i siguroi atij mbështetjen që i nevojitej. Për këto arsye, Komiteti konstaton se në rrethanat e çështjes në fjalë, shteti ka shkelur nenin 24 (2) (b) dhe (c) të Konventës.

Rekomandimet e Komitetit

- T'i sigurohet ankimesit një zgjidhje efektive, përfshirë kompensimin, dëmshpërblimin për abuzimet e pësuar dhe mbështetjen që është e nevojshme për t'i mundësuar atij që të jetojë përsëri i pavarur.
- Të kryhet një hetim i paanshëm, i shpejtë dhe efektiv mbi krimin, dhe të ndiqen penalisht autorët.
- Të publikohet ky komunikim në formate të arritshme në mënyrë që të jetë në dispozicion për të gjithë popullsinë.
- Masat e përgjithshme. Shteti palë është i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen. Në këtë drejtim, Komiteti i referohet rekomandimeve të Ekspertit të Pavarur për gëzimin e të drejtave të njeriut nga personat me albinizëm sikurse gjenden në raportin e tij drejtuar Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe i kërkon shtetit palë:
 - Të rishikojë dhe përshtatë kornizën ligjore sipas nevojës për të siguruar që ato të përfshijnë të gjitha aspektet e sulmeve kundër personave me albinizëm, përfshirë në lidhje me trafikimin e pjesëve të trupit;
 - Të sigurojë hetimin dhe ndjekjen penale të shpejtë të rasteve të sulmeve kundër personave me albinizëm si dhe trafikimit të pjesëve të trupit;
 - Të sigurohet që përdorimi i pjesëve të trupit për praktika të lidhura me magji të penalizohet në mënyrë adekuate në legjislacionin vendas;
 - Të zhvillojë dhe zbatojë fushata afatgjata për ngritjen e vetëdijes që bazohen në modelin e të drejtave të njeriut të aftësisë së kufizuar dhe janë në përputhje me detyrimet e shtetit palë sipas nenit 8 të Konventës, dhe trajnimin për të adresuar praktika të dëmshme dhe mite.

Komunikimi Nr. 26/2014: Simon Bacher **(përfaqësuar nga Viktoria Bacher, motra e tij binjake dhe kujdestare ligjore)**

Data e komunikimit: 8 shkurt 2014 (dorëzimi fillestar)

Data e miratimit të pikëpamjeve: 16 Shkurt 2018

Subjekti: Përgjegjësia e autoriteteve të shtetit palë për të promovuar aksesin e një personi me aftësi të kufizuara në kontekstin e një mosmarrëveshje private midis fqinjëve.

Çështjet e trajtuara: Mundësia e hyrjes; përshtatja e arsyeshme; detyrimet e përgjithshme të Shteteve Palë sipas Konventës.

Nenet e Konventës: 3, 9, 14, 19, 25, 26 dhe 28, neni 2 (c), (d) dhe (f) e Protokollit Opsional.

Faktet e çështjes

Z. Bacher ka lindur me sindromën Down. Ai është në spektrin e autizmit dhe herë pas here ka nevojë për një karrige me rrota. Ai gjithashtu ka një sëmundje pulmonare kronike dhe imunitet të cënuar që kërkojnë asistencë mjekësore. Ai vizitohet rregullisht pranë Spitalit Universitar në Innsbruck.

Z. Bacher jeton në qytetin e Vompit, në një shtëpi të cilën familja e bleu në vitin 1983. Shtëpia, dhe dy shtëpitë fqinje, janë të arritshme vetëm nëpërmjet një shtegu këmbësorësh. Kur prindërit e z. Bacher blenë shtëpinë, Kryetari i Bashkisë së Vompit u tha atyre se ishte përgjegjësia e tij ligjore që të krijonte akses në raste emergjence. Sidoqoftë, që kur Kryetari i Bashkisë u largua nga zyra, asgjë nuk u bë në lidhje me aksesin. Prindërit e z. Bacher kanë ndërtuar shkallë prej druri të mbushura me zhavorr përgjatë shtegut, i cili ka një gradient prej 18 përqind, është 35 metra i gjatë dhe 1,2 deri 1,5 metra i gjerë, dhe mbetet mënyra e vetme për të aksesuar ambientet e brendshme të shtëpisë. Kur bie shi, borë ose breshër, rruga bëhet veçanërisht e rrezikshme për z. Bacher dhe personat që e ndihmojnë atë. Ndërsa ai rritej, prindërit e tij nuk ishin në gjendje ta mirëmbanin dhe vendosën të ndërtonin një çati mbi shteg për ta mbrojtur atë nga moti i keq. Leja e planifikimit u dha nga autoritetet lokale për të ndërtuar një çati të tillë, me marrëveshjen e fqinjëve të afërt. Sidoqoftë, pronarët e njëres prej shtëpive fqinje (z. R. dhe xhaxhai i tij) nuk u ftuan të merrnin pjesë në takim për të diskutuar lejen e planifikimit, pasi me ligj duhej të konsultoheshin vetëm ata fqinj që jetonin brenda 15 metrave nga vendi i ndërtimit. Në përputhje me licencën e dhënë nga komuna Vomp, dhe me një grant nga pushteti lokal i Tirolit, çatia u ndërtua mes nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2001.

Z. R. (fqinji i pakonsultuar) paditi prindërit e autorit para Gjykatës së Rrethit Schwaz, duke pretenduar se çatia kishte zvogluar gjerësinë e shtegut nga 1.5 në 1.25 metra dhe se lartësia cënonte të drejtën e tij të kalimit ose lëvizshmërisë. Më 17 korrik të vitit 2002, Gjykata vendosi në favor të z. R. dhe urdhëroi që çatia të prishej.

Situata e z. Bacher dhe familjes së tij u bë subjekt i dy programeve televizive, në vitet 2003 dhe 2004. Prindërit e tij apeluan vendimin e prishjes para Gjykatës së Apelit në Innsbruck, duke pretenduar se qëllimi i vetëm i kulmit kishte qenë siguria e z. Bacher, dhe duke kërkuar që të merren parasysht aftësia e tij e kufizuar dhe rrethanat personale. Në vitin 2003, Kryetari i Bashkisë u informua për një rrugë alternative që ishte mbyllur dhe mund të shërbente për të aksesuar shtëpinë e z. R., duke zgjidhur kështu problemet e z. Bacher. Por ndodhi që në të njëjtin vit, një biznesmen bleu ngastrën ngjitur dhe rruga alternative nuk ishte më zgjidhje. Më 2 prill 2003, Gjykata Rajonale e Innsbruck-ut mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit Schwaz dhe vlerësoi kërkesë-padinë në shumën 4000 euro, duke parandaluar kështu çdo ankesë në një gjykatë më të lartë. Çatia ishte planifikuar të prishej në dhjetor të vitit 2003 dhe në ditën e prishjes, një përfaqësues i gjykatës, avokati i fqinjit dhe disa ndërtues arritën në pronë. Sidoqoftë, për shkak të një ndërhyrjeje nga pesë anëtarë të një OJF-je, të cilët kishin ardhur për të mbështetur z. Bacher dhe familjen e tij, ndërtuesit refuzuan të prishnin çatinë. Ndërkohë, më 2 prill 2004, një grup ndërtuesish erdhën në pronë pa paralajmërim dhe pa praninë e askujt hoqën çatinë. Familja e z. Bacher njoftoi policinë dhe zyrën e Kryetarit të Bashkisë, por askush nuk erdhi.

Kur çështja mori, për të disatën herë, vëmendjen e medias, një avokat ofroi ndihmën e tij falas për familjen dhe paraqiti një ankesë, pasi heqja ishte kryer në mungesë të një përfaqësuesi të gjykatës dhe punëtorët kishin hyrë në pronën e z. Bacher pa leje. Në ankesë, familja e z. Bacher paraqiti rreziqet me të cilat ai përballej si një person me aftësi të kufizuara pas heqjes së çatisë. Më 16 korrik 2004, Gjykata e Rrethit Schwaz vendosi që familja e Z. Bacher ishte “e vendosur të pranonte çmontimin e çatisë”, duke mos iu referuar pretendimeve për sigurinë e cënuar dhe nevojat specifike të z. Bacher. Më 1 tetor 2004, prindërit e z. Bacher apeluan kundër këtij vendimi. Më 22 prill 2005, gjykata rrëzoi ankesën dhe urdhëroi familjen Bacher të paguante koston e plotë të prishjes së çatisë, pa konsideruar pretendimet për mënyrën e gabuar të heqjes së çatisë dhe pa marrë në konsideratë pasojat e prishjes për zotin Bacher.

Në korrik të vitit 2004, një stuhi breshëri shkaktoi dëme të mëtejshme në shtegun e shtëpisë. Pushteti vendor i Tirolit dha ndihmë për riparimin, por, për shkak të vendimit të mëparshëm të Gjykatës Rajonale të Innsbruck-ut, z. R. duhej pyetur përpara se të bëhej ndonjë riparim në shteg. Si rezultat, shtegu, i cili ishte në gjendje shumë të dobët, nuk mund të rregullohej. Në tetor të vitit 2006, nëna e z. Bacher ra dhe theu krahun, ndërsa ndihmonte z. Bacher të dilte në shteg.

Gjatë asaj periudhe, z. Bacher filloi trajtimin ambulator për fibrozë cistike, e cila rriti nevojën për të përdorur shtegun. Për të zgjidhur situatën e tyre, më 21 gusht 2003, prindërit e z. Bacher i bënë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, e cila u përgjigj se nuk mund të shqyrtonte gjykimin e dhënë nga Gjykata. Ata më pas u përpoqën të negocionin privatisht me fqinj, i cili refuzoi të gjitha propozimet. Ata kërkuan mbështetjen e organizatës "PeopleFirst". Pas vendimit të Gjykatës Rajonale të Innsbruck-ut, avokatët nga Gjykata e Qarkut të specializuar në çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq gjetën një zgjidhje, duke sugjeruar një çati të palosshme, por pushteti vendor u përgjigj se një çati e tillë mund të shkaktonte sërish probleme ligjore dhe erefuzoi. U bënë disa përpjekje (madje edhe me Kryetarin e Bashkisë) për të kontaktuar Z.R. (fqinj) dhe trashëgimtarin e biznesmenit, i cili kishte blerë ngastrën e tokës dhe nuk lejonte ndërtimin e një ruge alternative, por pa sukses.

Prandaj, ata i ndaluan të gjitha përpjekjet për kontaktim, pasi Z. R. i kërcënoi verbalisht se do të padiste familjen për shkaktim dëmi, nëse vazhdonin ta ndiqnin çështjen.

Në mes të viteve 2011 dhe 2012, Ombudsmani për çështjet e aftësisë së kufizuar u përpoq të ndërmjetësonte me Kryetarin e Komunës së Vomp-it, i cili sugjeroi që z. Bacher të vendoset në një shtëpi tjetër ose që e gjithë familja të zhvendoset. U transmetuan edhe dy programe televizive, në të cilat morën pjesë Ministri i Drejtësisë dhe Avokati i Popullit. Në programin e vitit 2012, u lexua me zë një email i dërguar nga Kryetari i Bashkisë, i cili deklaronte përsëri se z. Bacher duhet të zhvendosej në një shtëpi për personat me aftësi të kufizuara ose familja duhet të zhvendosej.

Familja refuzoi të vendoste në institucion z. Bacher. Për sa i përket sugjerimit që ata të zhvendoseshin, ankimesi pohon se shtëpia i siguron z. Bacher një mjedis të njohur dhe stabilitetin që i nevojitet si person në spektrin e autizmit. Për më tepër, shtëpia e familjes është afër qendrës ditore që z. Bacher ndjek dhe Klinikës Universitare ku ai merr trajtimet e tij javore. Ankimesja shton se Tiroli është një zonë shumë e shtrenjtë dhe se familja nuk kishte mundësi të zhvendosej në një vendbanim të ngjashëm, sepse shtëpia e tyre është zhvlerësuar shumë pas shkatërrimit të shtegut dhe mungesës së aksesit.

Në nëntor të vitit 2009, familja e z. Bacher mori ndihmë juridike falas përmes kompanisë së sigurimeve. Bacher mund ta kishte përdorur atë në mënyrë të sigurt. Më 9 shkurt 2012, Gjykata e Rrethit Schwaz vendosi kundër familjes me arsyetimin se fqinjët e përdornin shtegun rrallë dhe për këtë arsye nuk ishin përgjegjës për mirëmbajtjen e tij. Familja e z. Bacher nuk apeloj kundër këtij vendimi, sepse e kuptoi që nuk kishte zgjidhje të mëtejshme, aq më tepër që tashmë i kishte humbur 30 000 euro. Në maj të vitit 2014, familja e z. Bacher kontaktoi Kryetarin e Komunës së Vomp-it për të

raportuar se fqinji kishte filluar ta përdorte shpesh shtegun. Kryetari i Komunës nuk pranoi të ndërmernte ndonjë veprim dhe sugjeroi që familja të kontaktonte gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Schwaz. Më 28 maj 2014, gjyqtari u përgjigj se çështja “nuk kishte asnjë lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” dhe se rruga ishte dëmtuar nga përdorimi i vetë familjes që e kishte atë.

Shkeljet

Ankimuesja pretendon se dështimi i shtetit në tërësi për të marrë në konsideratë situatën e z. Bacher dhe për të kuptuar “ndryshimin e paradigmes të krijuar nga qasja e të drejtave të njeriut në KDPAK” përbën një shkelje të të drejtave të tij, sipas neneve 3, 9, 14, 19, 25, 26 dhe 28 të Konventës.

Ajo pretendon se, megjithëse çatia u prish para hyrjes në fuqi të Konventës dhe Protokollit Opsional në shtetin palë, shkelja e të drejtave të vëllait të saj vazhdon akoma për shkak të vendimeve të miratuara nga autoritetet e shtetit palë pas hyrjes në fuqi të Konventës dhe Protokollit Opsional.

Lidhur me nenin 3, ankimuesja pretendon se e drejta e vëllait të saj për t’u trajtuar me respekt dhe dinjitet, dhe ajo për pjesëmarrje dhe përfshirje janë injoruar sistematikisht. Lidhur me nenin 9, ajo pretendon se e drejta e z. Bacher për aksesueshmëri është shkelur nga gjykatat përmes vendimeve të tyre, me të cilat ata kanë ndaluar familjen që të marrë masat e nevojshme për të mirëmbajtur rrugën dhe për të mundësuar përdorimin e sigurt të sa. Në veçanti, vendimi i vitit 2012 u miratua duke marrë parasysh vendimet e mëparshme, por duke mos marrë parasysh aftësinë e kufizuar të z. Bacher. Ankimuesja pretendon se të drejtat e vëllait të saj për liri dhe siguri sipas nenit 14 janë shkelur, sepse gjendja e pasigurt e shtegut e pengon atë të largohet nga shtëpia e tij në kushtet e motit të keq.

Ankimuesja më tej pretendon se e drejta e vëllait të saj për të jetuar në mënyrë të pavarur është cenuar nga mungesa e aksesueshmërisë në shtëpinë e tij, që ka kufizuar lëvizjen personale dhe të pavarur, në kundërshtim me nenin 19 të Konventës. Të drejtat e z. Bacher sipas neneve 25 dhe 26 për të pasur akses në shërbimet shëndetësore dhe rehabilitim gjithashtu janë shkelur, sepse gjendja e pasigurt e shtegut e ka penguar atë të marrë pjesë në trajtimet e tij.

Në lidhje me nenin 28, ankimuesja pretendon se mungesa e aksesit të sigurt në shtëpinë e familjes dhe kostot e larta të procedurave gjyqësore të pasuksesshme kanë shkelur të drejtën e vëllait të saj për një standard adekuat jetese.

Vlerësimi i Komitetit

Siç argumentohet nga shteti palë, e drejta e kalimit për këmbësorë dhe automjete i dhënë fqinjëve të familjes Bacher shkaktoi një mosmarrëveshje midis personave privatë, e cila nuk nisi drejtpërdrejt nga autoritetet. Në këtë drejtim, Komiteti vëren argumentin e shtetit palë, sipas të cilit detyrimet e shtetit palë shtrihen vetëm në marrëdhëniet juridike private në të cilat entitetet shtetërore ofrojnë lehtësira dhe shërbime që ofrohen për publikun, dhe nuk shtrihen në “çështje thjesht private”. Por, Komiteti gjithashtu thekson se këto lloj mosmarrëveshjesh drejtohen nga rendi juridik i shtetit palë, i cili, në çdo rast, mban përgjegjësinë përfundimtare për të siguruar që të drejtat e Konventës respektohen, përfshirë e drejta e një personi me aftësitë kufizuara për të pasur akses në shtëpinë e tij, akses në komunitet dhe në shërbimet publike, të tilla si arsimit dhe shëndetësia. Prandaj, megjithëse mosmarrëveshjet e shkaktuara nga ndërtimi i një çatie në një shteg janë midis dy individëve privatë, shteti palë ka detyrim, ndër të tjera, të garantojë që vendimet e miratuara nga autoritetet e tij të mos shkelin të drejtat e parashikuara në Konventë.

Shtetet janë të detyruara jo vetëm të respektojnë të drejtat e parashikuara në Konventë por, si rrjedhojë edhe të përmbahen nga shkelja e tyre, edhe t'i mbrojnë ato të drejta duke miratuar masa që parandalojnë ndërhyrjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individëve në këto të drejta. Kështu, edhe pse Konventa përcakton kryesisht të drejtat dhe detyrimet midis shtetit dhe individëve, fusha e veprimit të dispozitave të Konventës shtrihet në marrëdhëniet midis individëve privatë. Në lidhje me këtë, Komiteti gjithashtu thekson se sipas nenit 4 (1) të Konventës, shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa asnjë lloj diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, shtetet palë garantojnë të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar nga çdo person, organizatë ose ndërmarrjeje private. Një çështje e së drejtës pronësore lidhur me ushtrimin e një kontrate midis individëve dhe konfliktin që rrjedh prej saj duhet të interpretohet përmes Konventës. Prandaj, kur gjykatat e Shtetit Palë ndërhyjnë për të zgjidhur konfliktin midis palëve, ato ishin të detyruara nga dispozitat e Konventës. Argumenti i Shtetit Palë që komunikimi ka të bëjë me një mosmarrëveshje që është ekskluzivisht midis individëve dhe për këtë arsye konventa nuk zbatohet, nuk qëndron.

Komiteti rithekson se “aksesueshmëria është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë

të barabartë në shoqëri”. Në përputhje me nenin 9 të Konventës, shtetet palë marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses, në mënyrë të barabartë me të tjerët, në mjedisin fizik, në transport dhe në pajisje dhe shërbime të tjera të hapura ose të ofruara për publikun, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale. Këto masa përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave.

Komiteti më tej rikujton se, në përputhje me nenin 2 të Konventës, përshtatja e arsyeshme duhet të sigurohet sipas nevojës, përmes modifikimeve dhe rregullimeve të nevojshme, duke mos imponuar një barrë të shpërpjesëtuar ose të panevojshme, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin e të gjitha të drejtave të njeriut dhe liritë themelore në kushte të barabarta me të tjerët, përfshirë të drejtën e tyre për aksesueshmëri.

Në këtë kontekst, fokusi nuk është më te personaliteti juridik apo natyra publike ose private e atyre që kanë në pronësi ndërtesa, infrastrukturë transporti, automjete, informacione dhe komunikim e shërbime. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses të barabartë në të gjithë mallrat, produktet dhe shërbimet që janë të hapura ose të ofruara për publikun, në një mënyrë që siguron aksesin e tyre efektiv dhe të barabartë, si dhe respekton dinjitetin e tyre.

Komiteti rikujton që, kur vlerësojnë arsyeshmërinë dhe përpjesëtimërinë e masave të përshtatjes, Shtetet Palë gëzojnë një diferencë të caktuar vlerësimi. Më tej, ai vëren se në përgjithësi u takon gjykatave të Shteteve Palë në Konventë të vlerësojnë faktet dhe provat në një rast të veçantë, përveç nëse konstatohet se vlerësimi është qartësisht arbitrar ose i padrejtë. Në këtë rast, roli i Komitetit është të vlerësojë, nëse vendimet e miratuara nga gjykatat e shtetit palë kanë mundur respektimin e të drejtave të z. Bacher sipas nenit 9, vetëm dhe në lidhje me nenin 3 të Konventës.

Komiteti vëren se prishja e çatisë në shtegun që çon në shtëpinë e familjes Bacher nuk kufizon vetëm aksesin e z. Bacher në shtëpinë e tij, por gjithashtu kufizon aksesin e tij në aktivitetet sociale dhe shërbimet publike në jetën e përditshme, të tilla, si: arsimi, institucionet shëndetësore dhe shërbimet publike në përgjithësi. Ai gjithashtu vë në dukje argumentin e autorit se z. R. nuk pranoi asnjë nga alternativat e propozuara për të mbuluar rrugën dhe se, kur vlerësuan situatën, gjykatat nuk konsideruan se ishte e rëndësishme të merrej parasysh situata e z. Bacher. Në këtë kontekst, Komiteti vëren se, me vendimin e tij të datës 9 shkurt 2012, Gjykata e Rrethit Schwaz qëndroi në të njëjtën linjë me vendimet e mëparshme të gjykatave të Shtetit Palë në çështjen në fjalë: ajo nuk bëri një analizë të hollësishtme të nevojave e veçanta të z. Bacher, përkundër faktit që ato ishin referuar qartë nga prindërit e tij, si në të gjitha seancat gjyqësore. Autoritetet e shtetit palë në vend të kësaj arritën

në përfundimin se procedurat gjyqësore nuk kishin të bënin me aftësinë e kufizuar dhe u përqendruan në zgjidhjen e çështjes së të drejtave pronësore në fjalë. Pasojat e shumta të vendimeve të miratuara nga autoritetet e shtetit palë mbi aksesin e z. Bacher u injoruan, duke i lënë familjes së tij përgjegjësinë për të gjetur mënyra për të mundësuar hyrjen e tij në shtëpinë e tij dhe në shërbimet publike. Prandaj, Komiteti vëren se vendimi i Gjykatës Schwaz i datës 9 shkurt 2012, lexuar në kontekstin e vendimeve gjyqësore të mëparshme të miratuara nga gjykatat e shtetit palë në çështjen, përbën mohim të drejtësisë për z. Bacher, në shkelje të nenit 9, veçmas dhe në lidhje me nenin 3 të Konventës.

Rekomandimet

- Shteti palë është i detyruar t'i sigurojë z. Bacher, një mjet efektiv juridik, në veçanti:
- Të lehtësojë një zgjidhje të konfliktit në lidhje me përdorimin e rrugës, e cila është mjeti i vetëm për të aksesuar shtëpinë e familjes Bacher, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të z. Bacher si një person me aftësi të kufizuara;
- T'i akordojë z. Bacher kompensim financiar për shkeljet;
- Të rimbursojë autorin për shpenzimet ligjore të bëra në mënyrë të arsyeshme në procedurat e brendshme dhe në përpunimin e komunikimit aktual.
- Shteti palë është gjithashtu i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen:
- Sigurimi i rritjes së kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe gjykatave përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të standardeve të aksesit.
- Zhvillimi i një kornize efektive monitorimi dhe ngritjen e organeve të efektive të monitorimit me kapacitete adekuate dhe mandate të përshtatshme për të siguruar që konventa të zbatohet.

Komunikimi Nr. 2/2010, 4 prill 2014 Liliane Gröninger

Data e komunikimit: 25 qershor 2010

Data e miratimit të pikëpamjeve: 4 Prill 2014

Subjekti: Dështimi për të promovuar të drejtën për të punuar, duke mos ndihmuar në përfshirjen e një personi me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Çështjet e trajtuara: Parimet, detyrimet e përgjithshme, barazia dhe mos diskriminimi; ndërgjegjësimi; puna dhe punësimi.

Netet: 3, 4, 5, 8 dhe 2; netet e Protokollit Opsional: 2 (d) dhe (e)

Faktet e ngjarjes

Ankimuesja bëri një ankesë për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar në nëntor 2009 në zyrën e Shërbimit Specialist të Integritimit (Integrationsfachdienst, IFD) dhe Zyrën e Integritimit të Këlnit nga Autoriteti Rajonal i Rhineland, në të cilin ajo raportoi “diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në integrimin e tyre në tregun e punës”. Ankimuesja pohon se gjatë takimit me përfaqësuesit e institucioneve cilësuar më lart “diskriminimi u confirmua pa mëdyshje” dhe se asaj iu tha se Autoriteti Rajonal nuk kishte mjete ligjore për të ndihmuar djalin e saj.

Ankimuesja pohon se djali i saj nuk kishte akses në programet e përgjithshme profesionale të orientimit dhe trajnimit, si dhe ato të punësimit. Djali i saj ndiqet nga një logoped dhe një fizioterapist dhe luan pingpong për të ruajtur aftësitë e tij mendore dhe fizike dhe familja financon këto aktivitete. Në tetor- nëntor 2009, ai gjithashtu ndoqi dhe përfundoi me sukses një kurs arkëtari profesional, por agjencia e punësimit refuzoi të siguronte mbështetje financiare, me argumentin se trajnimi nuk ishte efektiv nga pikëpamja e kostove financiare. Ankimuesja pretendon se procesi gjyqësor ka mbi tre vjet në Gjykatën Sociale të Këlnit. Në mars-prill 2010 dhe prill-maj 2011, djali i ankimueses përfundoi një kurs kontabiliteti dhe familja mbuloi përsëri koston, pasi as trajnimi dhe as mbështetja financiare nuk u mbuluan nga agjencia e punësimit. Ankimuesja deklaroi se agjencia e punësimit vendosi në një situatë disavantazhi personat me aftësi të kufizuara dhe pas disa vitesh papunësie ata nuk ishin më në gjendje të ofronin asgjë në tregun e punës që më pas të mund të shkonin në workshop-e të posaçme për personat me aftësi të kufizuara. Ankimuesja më tej pohon se djali i saj nuk ka marrë mbështetje nga agjencia e punësimit kur kërkonte punë. Ankimuesja ka paraqitur një listë me 10 pozicione për të cilat djali i saj aplikoi dhe u intervistua, dhe pretendon se pasi kontaktuan agjencinë e punësimit, punëdhënësit

refuzuan kërkesat e tij. Ajo më tej pohon se përpjekjet e agjencisë së punësimit për të ndihmuar ish-in të kufizuara thjesht në dërgimin e “ofertave”, të cilat ish-in në fakt thirrje të përgjithshme për aplikime nga ndërmarrjet dhe shpesh ish-in jashtë afatit ose të papërshtatshme për nevojat e tij.

Ankimuesja pohon se çdo masë që merr agjencia e punësimit dështon, sepse sipas ligjit, djali i saj ka të drejtë për një subvencion integrimi vetëm nëse aftësia e tij e plotë e punës mund të rikthehet brenda tre vjetësh. Ajo deklaron se është pikërisht legjislacioni social që parandalon përfshirjen në tregun e punës.

Ankimuesja pohon se djali i saj ka ndjekur një kopsht dhe shkollë të zakonshme dhe se ajo i kishte siguruar edhe terapi shtesë. Ajo deklaron se ai arriti të diplomohej nga një shkollë e mesme e zakonshme (Fachoberschulreife) përkundër pengesave të shumta. Ajo më tej përshkruan problemet që djali i saj hasi gjatë trajnimit të tij profesional dhe pohon se agjencia e punësimit e caktoi atë në një program trajnimi, i cili nuk ishte i autorizuar për të trajnuar persona me aftësi të kufizuara, dhe se praktika e tij nuk do të njihej, edhe nëse ai do ta kishte kaluar me sukses provimin përfundimtar. Në këto kushte, ai ndryshoi ofruesin e trajnimit dhe arriti të finalizonte trajnimin e tij profesional pavarësisht se sërish nuk iu dha asnjë ndihmë.

Ankimuesja pohon se djali i saj nuk ka marrë ndonjë ndihmë nga asnjë prej agjencive të punësimit ku ishte regjistruar për të fituar përvojë pune ose për të lehtësuar përfshirjen e tij në tregun e punës.

Pengesat kryesore me të cilat përballen agjencitë e punësimit janë legjislacioni shoqëror në fuqi dhe ndarja e përgjegjësive ndërmjet institucioneve të ndryshme për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Ajo i kërkoj një eksperti ligjor t'i shpjegonte mundësitë ligjore të agjencive të punësimit për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës dhe sipas tij, përfshirja në tregun e punës është praktikisht e pamundur për të interesuarit. Kjo pasi për personat me aftësi të kufizuara të përhershme, përfshirja në tregun e punës nuk bëhet përmes mbështetjes që ofrohet me të ashtuquajturat “pagesa integrimi”, pasi një përfitim i tillë nuk përputhet me objektivin e ligjit. Kjo mangësi ose problem i ligjit në zbatimin e pagesave të integritit ka një ndikim negativ tek të interesuarit, pasi nuk ka një formë tjetër mbështetjeje për ta në tregun e punës.

Ankimuesja parashtron se, kur i biri aplikon për punë, mund të prezantohet vetëm tek një menaxher dyqani dhe të paraqesë kërkesën e tij. Pas kësaj, “fati i tij” qëndron në duart e agjencisë së punësimit. Meqenëse, sipas legjislacionit social, djali i saj nuk është i përshtatshëm për një pagesë integrimi, punëdhënësit potencialë tërheqin

ofertat e tyre. Ankimuesja pretendon se personat me aftësi të kufizuara nuk trajtohen në mënyrë të barabartë në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara, kur ata aplikojnë për një vend pune, dhe se qeveria federale fsheh faktin që legjislacioni social pengon integrimin e tyre në tregun e punës.

Pagesat e integritit janë të vetmet masa pozitive në dispozicion për të ndihmuar djalin e saj me përfshirjen e tij në tregun e punës. Ajo përsërit se ai ka një numër të konsiderueshëm kualifikimesh, por integrimi i tij në tregun e punës ka dështuar për shkak të legjislacionit në fuqi.

Shkeljet

Ajo pretendon se djali i saj është viktimë e shkeljeve të të drejtave të tij nga shteti gjerman, sipas neneve 3, 4, 8 dhe 27 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Konventa). Megjithëse autori nuk ka vendosur nenin 5 në mënyrë specifike, komunikimi gjithashtu duket se përmban në thelb edhe çështje që kanë të bëjnë me këtë nen.

Vlerësimi i Komitetit

Komiteti vëren pretendimet e ankimueses se dispozitat e legjislacionit social në lidhje me dhënien e një pagese integriti janë diskriminuese, pasi ato janë të zbatueshme vetëm për personat me aftësi të kufizuara, aftësia e plotë e punës e të cilëve mund të rikthehet brenda 36 muajve. Këto subvencione nuk krijojnë në fakt të drejta për personat me aftësi të kufizuara, pasi e drejta për të kërkuar një subvencion të tillë i përket ekskluzivisht punëdhënësit dhe diskrecioni që kanë agjencitë e punësimit në zbatimin e tyre çon në diskriminim të mëtejshëm. Komiteti gjithashtu vëren parashtrimin e shtetit palë se djali i ankimueses është i përshtatshëm për një pagesë të tillë integriti, nëse plotësohen kriteret ligjore. Sipas tyre, një punëdhënës duhet të bëjë një ofertë punësimi për djalin e ankimueses dhe të aplikojë për pagesën e integritit, pas kësaj, agjencia e punësimit vlerëson rastin dhe merr një vendim për kohëzgjatjen dhe shumën e pagesës së integritit. Në çdo rast, sipas parashtrimit të shtetit palë, subvencionin do të arrinte në një maksimum prej 70 përqind të pagës, për një periudhë maksimale prej 60 muajsh.

Komiteti vëren se qëllimi pas skemës së sipërpërmendur të pagesave të integritit

duket të jetë nxitja e punëdhënësve privatë për të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Komiteti vëren, megjithatë, se skema e përmendur në praktikë kërkon që punëdhënësit të kalojnë nëpër një proces shtesë, kohëzgjatja dhe rezultati i të cilit nuk janë të sigurt, dhe se personi me aftësi të kufizuara nuk ka mundësi të marrë pjesë në proces. Politika duket se është në përputhje me modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar, sepse ajo tenton ta konsiderojë aftësinë e kufizuar si diçka që është kalimtare dhe që, si pasojë, mund të “tejkalohej ose kurohet” me kalimin e kohës. Politika nuk është në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 3 të Konventës, të lexuara së bashku me paragrafët (i) dhe (j) të preambulës. Komiteti gjithashtu vëren se, në rastin e djalit të ankimeses, skema e mësipërme duket se ka shërbyer si një “frenues” më shumë se sa si një nxitje për punëdhënësit.

Komiteti vëren se neni 27 i Konventës nënkupton një detyrim nga ana e shteteve palë për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për punësimin, përfshirë në sektorin privat. Komiteti më tej vëren se neni 4, paragrafi 1 (a), i Konventës i imponon shtetit palë detyrimin e përgjithshëm për të miratuar të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në Konventë në lidhje me punësimin. Ai gjithashtu vëren se neni 3 përcakton që në legjislacionin, politikën dhe praktikën e tij shteti palë duhet të udhëhiqet nga respektimi i dinjitetit, autonomisë individuale duke përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet dhe pavarësinë e personave, mosdiskriminimin, pjesëmarrjen, përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri dhe barazinë e mundësive.

Në rastin në fjalë, Komiteti është i mendimit se modeli ekzistues për sigurimin e pagesave të integritit nuk promovon në mënyrë efektive punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Komiteti konstaton në veçanti se ka vështirësi të dukshme me të cilat përballen punëdhënësit e mundshëm kur përpiqen të marrin pjesë në skemën e pagesave të integritit për punësimin e një personi me aftësi të kufizuara dhe kjo ndikon në efektivitetin e kësaj skeme. Procedurat komplekse administrative i vënë aplikantët në një pozitë të pafavorshme, që nga ana tjetër mund të rezultojë në diskriminim të tërthortë. Prandaj Komiteti vëren se skema e pagesave të integritit, siç zbatohet në rastin e djalit të ankimeses, nuk është në përputhje me detyrimet e shtetit palë sipas nenit 27, paragrafi 1 (h), lexuar së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), neni 4, paragrafi 1 (a) dhe neni 5, paragrafi 1, i Konventës.

Komiteti vëren pretendimin e ankimeses se pagesa e integritit është e vetmja masë pozitive në dispozicion për të ndihmuar djalin e saj për përfshirjen në tregun e punës.

Komiteti më tej vëren se në realitet masat e aplikuara nga autoritetet e shtetit palë për të ndihmuar integritin e tij në tregun e punës përfshinin: dhënie të pagesave të

papunësisë për periudha të paspecifikuara kohore, takime këshilluese dhe kontrolle për të parë nëse djali ndodhet në zonën në të cilën ishte caktuar dhe nëse ai paraqitet rregullisht për takime. Autoritetet gjithashtu i kishin propozuar vende të lira pune, disa prej të cilave ishin joaktuale.

Komiteti më tej vëren se përfaqësuesit e shtetit palë duket të jenë të mendimit se përpjekjet e djalit të ankimueses për të rritur kualifikimet e tij përmes arsimit të vazhdueshëm dhe fakti që ai kishte pranuar disa herë punë me kohë të pjesshme, përbëjnë një pengesë për përpjekjet e agjencive të punës për ta ndihmuar atë. Së fundmi, Komiteti vëren se masa e zbatuar për rastin e djalit të ankimueses ishte e kufizuar në krahasim me listën e gjerë të masave në dispozicion të përshkruara nga shteti palë. Komiteti vëren se neni 27, paragrafi 1 (d) dhe (e), i Konventës parashikon të drejtat për të përfituar nga masat e duhura të promovimit të mundësive të punësimit, të tilla, si: akses efektiv në shërbimet e përgjithshme të punësimit dhe punësimi. Komiteti është i mendimit se masat e marra nga autoritetet përgjegjëse të shtetit palë për të ndihmuar integrimin e djalit të ankimueses në tregun e punës nuk plotësojnë standardin e detyrimeve të shtetit palë sipas nenit 27, paragrafi 1 (d) dhe (e), lexoni së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), nenin 4, paragrafi 1 (a) dhe (b) dhe nenin 5, paragrafi 1, të Konventës.

Komiteti është i mendimit se shteti palë ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 27, paragrafi 1 (d), (e) dhe (h), lexuar së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), nenin 4, paragrafi 1 (a) dhe (b), dhe neni 5, paragrafi 1, i Konventës.

Rekomandimet

- Shteti palë është i detyruar të rregullojë situatën duke përmbushur detyrimet e tij sipas Konventës ndaj djalit të autorit, përfshirë duke rivlerësuar çështjen e tij dhe duke zbatuar të gjitha masat në dispozicion sipas legjislacionit vendas në mënyrë që të promovojë në mënyrë efektive mundësitë e punësimit nën dritën e KDPAK;
- Shteti palë duhet gjithashtu të sigurojë kompensim adekuat për djalin e ankimueses, duke përfshirë kompensimin për shpenzimet e bëra për këtë komunikim;
- Duke marrë parasysh që legjislacioni i shtetit palë për këtë çështje është miratuar para ratifikimit të Konventës, shteti palë është i detyruar të marrë hapa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, përfshirë duke rishikuar përmbajtjen dhe funksionimin e skemës për sigurimin e pagesave të integritetit

për personat me aftësi të kufizuara të përhershme, për të siguruar përputhjen e plotë të saj me parimet e Konventës dhe duke siguruar që punëdhënësit e mundshëm të mund të përfitojnë në mënyrë efektive nga skema, kur është e përshtatshme.

Komunikimi Nr. 4/2011, 9 shtator 2013

Zsolt Bujdosó, Jánosné IldikóMárkus, Viktória Márton, Sándor Mészáros, Gergely Polk dhe János Szabó

(përfaqësuar nga avokati, János Fiala, Qendra për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar)

Data e komunikimit: 14 shtator 2011

Data e miratimit: 9 shtator 2013

Subjekti: Dështimi nga shteti palë për të eliminuar diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar dhe për të respektuar detyrimin për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike, përfshirë të drejtën e votës, në kushte të barabarta me qytetarët e tjerë.

Çështjet e trajtuara: Njohja e barabartë para ligjit dhe efektive kundër diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar; pjesëmarrja në jetën politike dhe publike.

Nenet e Konventës: Nenet 12 dhe 29

Faktet e çështjes

Të gjashtë ankimuesit kanë aftësi të kufizuar intelektuale dhe janë në kujdestari ligjore të pjesshme ose të plotë në përputhje me vendimet gjyqësore. Si pasojë e vendosjes së tyre nën kujdestari, emrat e ankimuesve u fshinë nga regjistri zgjedhor, në përputhje me nenin 70, paragrafi 5, të Kushtetutës hungareze që ishte i zbatueshëm në atë kohë, i cili parashikonte që personat e vendosur në kujdestari ligjore të pjesshme ose të plotë ose kujdestaria e pjesshme nuk kishin të drejtë vote. Për shkak të këtij kufizimi të zotësisë së tyre për të vepruar, ankimuesve iu mohua e drejta për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare hungareze të mbajtura më 11 prill 2010 dhe zgjedhjet vendore të mbajtura më 3 tetor 2010.

Ankimuesit pohojnë se si persona nën kujdestari, zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 70, paragrafi 5, i Kushtetutës automatikisht i fshiu nga regjistri zgjedhor. Vendimet për heqjen e zotësisë për të vepruar në këtë mënyrë nuk morën parasysh aftësinë e tyre

për të votuar, pasi ato u përjashtuan në mënyrë automatike. Ankimuesit argumentojnë se ata janë në gjendje të kuptojnë çështjet politike dhe të marrin pjesë në zgjedhje. Ata pohojnë se kjo fshirje automatike është e pajustificueshme dhe është në shkelje të nenit 29, vetëm dhe në lidhje me nenin 12 të Konventës.

Lidhur me shterimin e mjeteve juridike të brendshme, ankimuesit pretendojnë se nuk kishte asnjë zgjidhje efektive për ta. Ata pretendojnë se mund të kishin paraqitur një kërkesë për heqjen e kujdestarisë së tyre sipas nenit 21 të Kodit Civil, por që kjo do të rivendoste të drejtën e tyre për të votuar vetëm nëse do t'u kishte rikthyer plotësisht zotësinë për të vepruar. Kjo nuk ishte as e mundur dhe as e dëshirueshme nga ankimuesit, të cilët e pranojnë që si pasojë e aftësisë së kufizuar intelektuale kërkojnë mbështetje në menaxhimin e punëve të tyre në fusha të caktuara të jetës së tyre. Ligji hungarez parashikon vetëm kujdestarinë e plotë ose të pjesshme për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë të tillë. Ndërsa heqja e tyre nga kujdestaria sipas Kodit Civil është i vetmi mjet juridik i disponueshëm, ai nuk përbën një mjet efektiv juridik pasi gjykatat nuk kanë fuqi të marrin në konsideratë dhe të rivendosin të drejtën e një personi për të votuar. Ankimuesit i referohen vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen AlajosKiss v. Hungarisë, në të cilën Gjykata pranoi këtë argument nga pala paditëse, e cila po sfidonte në mënyrë të ngjashme kufizimin e të drejtës së tyre të votës për shkak të vendosjes nëkujdestari ligjore.

Ankimuesit nuk paraqitën ankesë sipas paragrafit 82 të Aktit C të vitit 1997 mbi Procedurën Zgjedhore në lidhje me fshirjen e emrave të tyre nga regjistri zgjedhor. Ata pretendojnë se një ankesë e tillë do të ishte trajtuar nga komiteti zgjedhor vendor dhe nga gjykata përkatëse e qytetit. Sidoqoftë, asnjë nga këto autoritete nuk ka fuqi të rikthejë të drejtën e autorëve për të votuar dhe të urdhërojë përfshirjen e tyre në listën zgjedhore, pasi ky përjashtim është i bazuar në Kushtetutë. Ata pretendojnë kështu që, meqë kjo procedurë nuk mund të çonte në rivendosjen e të drejtës së tyre për të votuar, nuk ishte një mjet efektiv që duhet ta shteronin.

Shkeljet

Ankimuesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e parashikuara në nenet 29 dhe 12 të Konventës dhe i kërkojnë Komitetit që t'i rekomandojë Hungarisë të realizojë ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore të brendshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, si dhe shpërblime për dëmin që u ka shkaktuar ankimuesve.

Vlerësimi i komitetit

Komiteti ka marrë parasysh argumentet e shtetit se, neni 70, paragrafi 5, i Kushtetutës është shfuqizuar dhe tani legjislacioni i ri parashikon një vlerësim të individualizuar të së drejtës së një personi për të votuar, bazuar në zotësinë për të vepruar, pra ligjet hungareze tani janë në përputhje me nenin 29 të Konventës. mbi kushte të barabarta me të tjerët.

Komiteti vëren se shteti palë thjesht ka përshkruar, në mënyrë abstrakte, legjislacionin e ri të zbatueshëm për personat nën kujdestari, duke deklaruar se ai e ka sjellë atë në përputhje me nenin 29 të Konventës, pa treguar se si ky ligj i ri ndikon posaçërisht tek ankimuesit, dhe shkalla në të cilën respekton të drejtat e tyre sipas nenit 29 të Konventës. Shteti palë nuk i është përgjigjur ankimuesve në lidhje me pamundësinë për të votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 me gjithë ndryshimet legjislative të paraqitura.

Komiteti rikujton se neni 29 i Konventës u kërkon shteteve palë të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë efektivisht dhe plotësisht në jetën politike dhe publike, në kushte të barabarta me të tjerët, duke përfshirë garantimin e të drejtës së tyre për të votuar. Neni 29 nuk parashikon ndonjë kufizim ose përjashtim të arsyeshëm për ndonjë grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, një përjashtim i të drejtës për të votuar në bazë të një aftësie intelektuale ose të shëndetit mendor, të perceptuar ose reale, përfshirë një kufizim në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, brenda kuptimit të nenit 2 të Konventës. Komiteti u referohet vëzhgimeve të tij përfundimtare mbi Tunizinë, në të cilat rekomandoi "miratimin urgjent të masave legjislative për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që janë aktualisht nën kujdestari ligjore, të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës dhe të marrin pjesë në jetën publike, në kushte të barabarta me të tjerët.

Komiteti më tej u referohet vëzhgimeve të tij përfundimtare mbi Spanjën, në të cilat shprehu shqetësim të ngjashëm për faktin se e drejta për të votuar e personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose të shëndetit mendor mund të kufizohet nëse personit në fjalë i është hequr zotësia juridike për të vepruar, ose kur është vendosur në një institucion. Komiteti vëren se të njëjtat parime zbatohen për çështjen në fjalë. Prandaj, Komiteti vëren se nenet përkatësie të ligjit të ri të miratuar, të cilat lejojnë një vlerësim sipas të cilit gjykatat privojnë nga e drejta e tyre për të votuar dhe për t'u zgjedhur personat me aftësi të kufizuara intelektuale, është në kundërshtim me nenin 29 të Konventës.

Komiteti më tej rikujton se sipas nenit 12, paragrafi 2, i Konventës, shtetet palë duhet të njohin dhe mbështesin zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara «në kushte të barabarta me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës», përfshirë jetën politike, e cila përfshin të drejtën e votës. Sipas nenit 12, paragrafi 3, i Konventës, shtetet palë kanë një detyrim pozitiv të marrin masat e nevojshme për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara ushtrimin aktual të kapacitetit ligjor, që përfshin zotësinë juridike për të vepruar, përveç zotësisë juridike. Rrjedhimisht, Komiteti është i mendimit se, duke privuar ankimesit nga e drejta për të votuar, bazuar në një aftësinë e tyre të kufizuar intelektuale të perceptuar ose reale, shteti palë nuk ka arritur të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 29 të Konventës, vetëm dhe së bashku me nenin 12 të Konventës.

Pasi ka arritur në përfundimin se vlerësimi i individualizuar i aftësisë së individëve ka natyrë diskriminuese, Komiteti vlerëson se kjo masë nuk mund të jetë e ligjshme dhe nuk është përpjesëtimore me qëllimin e ruajtjes së integritetit të sistemit politik të shtetit palë. Komiteti rikujton që, sipas Nenit 29 të Konventës, nga shteti palë kërkohet që të adaptojë procedurat e tij të votimit, duke siguruar që ato të jenë “të përshtatshme, të arritshme dhe të lehta për t'u kuptuar dhe përdorur”, dhe, kur është e nevojshme, duke lejuar personat me aftësi të kufizuara, me kërkesën e tyre, të asistohen nga të tjerë gjatë votimit. Vetëm kështu shteti palë do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara intelektuale votojnë në mënyrë kompetente, në kushte të barabarta me të tjerët, ndërsa garanton fshehtësinë e votimit.

Prandaj, Komiteti konstaton se shteti palë nuk ka arritur të përmbushë detyrimet e tij, sipas Nenit 29, vetëm dhe në lidhje me nenin 12 të Konventës.

Rekomandimet

- Shteti palë është i detyruar të rregullojë fshirjen e emrave të autorëve nga regjistrat zgjedhorë, përfshirë duke u siguruar atyre një kompensim adekuat për dëmet morale të shkaktuara si rezultat i privimit nga e drejta e tyre e votës në zgjedhjet e vitit 2010, si dhe për shpenzimet ligjore të bëra gjatë këtij komunikimi;
- Shteti palë është i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, duke përfshirë:
- Shfuqizimin dispozitave të ligjit të ri që lejon vlerësim të individualizuar, duke pasur parasysh që ato janë në kundërshtim me nenet 12 dhe 29 të Konventës;

- Miratimin e ligjeve që njohin, pa ndonjë “vlerësim të kapacitetit”, të drejtën e votës për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ata me më shumë nevojë për mbështetje, dhe që sigurojnë ndihmë të përshtatshme dhe përshtatje të arsyeshme në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre politike;
- Mbështetjen dhe garantimin në praktikë të së drejtës për të votuar për personat me aftësi të kufizuara, mbi kushte të barabarta me të tjerët, siç kërkohet nga neni 29 i Konventës, duke siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të arritshme dhe të lehta për t’u kuptuar dhe përdorur, dhe kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, duke lejuar ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.

Komunikimi Nr. 8/2012 paraqitur nga: Z. X (përfaqësuar nga avokati, Valeria G. Corbacho)

Data e komunikimit: 22 qershor 2012 (dorëzimi fillestar)

Data e miratimit të Pamjeve: 11 prill 2014

Subjekti: Mohimi i arrestit në kushte shtëpie, kushtet e paraburgimit, aksesit në kujdes mjekësor dhe shërbimet e përshtatshme rehabilituese në kohën e duhur.

Çështjet e trajtuara: Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar; përshtatja e arsyeshme; barazia dhe mosdiskriminimi; aksesueshmëria; e drejta për jetë, shëndet dhe rehabilitim.

Nenet: 9; 10; 13; 14, paragrafi 2; 15, paragrafi 2; 17; 25; dhe 26; Protokollit Opsional, neni 2 (d) dhe (e).

Faktet e çështjes

Ankimuesi është mbajtur në ambientet e paraburgimit për një gjykim penal kundër tij. Me autorizimin e Gjykatës, ai i është nënshtruar një operacioni në shtyllën kurrizore në vitin 2010 për të zëvendësuar një disk, i cili ishte vendosur në vitin 1999 pas një aksidenti automobilistik. Pas ndërhyrjes, ankimuesi pësoi një goditje në tru, e cila rezultoi në një çrregullim të ekuilibrit shqisor, çrregullim njohës (konjitiv) dhe në shikim. Për më tepër, ankimuesi pretendon se pllaka ishte vendosur gabimisht gjatë operacionit.

Disa kohë më vonë, ankimuesi u transferua në institutin "FLENI" (i specializuar) në Escobar, ku gjendja e tij u stabilizua dhe ai filloi një program rehabilitimi në spital.

Pas disa kohësh, Gjykata Federale Penale u informua nga instituti "FLENI" se ankimuesi ishte i aftë të vazhdonte programin e tij të rehabilitimit si pacient ditor, pra jo si i shtruar. Në të njëjtën datë, ankimuesi kërkoi që perioda në paraburgim të kryhej në kushtet e arrestit në shtëpi. Ankimuesi pretendoi se ai vazhdoi të kishte nevojë për trajtim të përditshëm rehabilitues si pacient ditor dhe hapësirë të përshtatshme si person me aftësi të kufizuar; dhe se largësia mes qendrës së paraburgimit dhe spitalit rehabilitues duhej të merrej në konsideratë pasi do ta pengonte mundësinë e tij për rehabilitim, duke cënuar kështu të drejtën për kujdes mjekësor. Prandaj, ai pretendoi që arresti në kushtet e shtëpisë ishte mënyra më e përshtatshme e trajtimit të tij, pasi në shtëpi ai kishte një person të besuar për ta ndihmuar me nevojat e përditshme, ambientet e përshtatura dhe aksesin më të lehtë në institutin "FLENI."

Më 9 qershor 2010, dy mjekë nga Departamenti i Gjykatës Supreme të Mjekësisë Ligjore ekzaminuan ankimuesin me kërkesë të Gjykatës Federale Penale dhe arritën në përfundimin që trajtimi në institutin "FLENI" ishte i përshtatshëm, ankimuesi kishte nevojë për ndihmë dhe se duhej të lëvizte me ambulancë të posaçme, për shkak të gjendjes së tij. Ankimuesi mori edhe vërtetim si person me aftësi të kufizuar që kishte nevojë për ndihmë nga të tjerë.

Kërkesat e ankimuesit për arrest në kushte shtëpie janë refuzuar në mënyrë të vazhdueshme.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore, i cili kishte ekzaminuar ankimuesin duke deklaruar se një vlerësim klinik neurokirurgjik ishte urgjentisht i nevojshëm dhe se spitali i burgut "nuk ka infrastrukturën që pacienti kërkon dhe megjithëse jeta e tij nuk është në rrezik, qëndrimi në kushtet aktuale të paraburgimit ku ai nuk mund të marrë kontrollet ose trajtimet që i duhen (ndihma me ushqyerjen dhe trajtimi psikiatrik) do të dëmtonte rëndë gjendjen e tij dhe mund të rrezikojë jetën e tij".

Zyra e Avokatit të Popullit kërkoi në Gjykatën Federale Penale për dërgimin e ankimuesit në institutin "FLENI" për trajtim të menjëhershëm si një masë paraprake që duhej marrë pa vonesë për të parandaluar shfaqjen e lezioneve si rezultat i kushteve të papërshtatshme. Më 26 gusht 2010, ankimuesi u transferua në institutin "FLENI" në Escobar.

Më 3 nëntor 2010, neurokirurgu në institutin "FLENI" përcaktoi se shtylla e tij kurrizore ishte e paqëndrueshme, mund të nevojitej një ndërhyrje dhe udhëtimi me ambulancë e rëndonte gjendjen e tij dhe duhej të ndodhte vetëm kur ishte absolutisht

e nevojshme. Gjykata Federale Penale kërkoi që Instituti të sigurojë një ambulancë moderne me një mjek në dispozicion që vlerësonte gjendjen e ankimuesit para çdo udhëtimi. Pas disa lëvizjeve në spitale të ndryshme, ankimuesi u shtrua në spital në Institutin Argjentinës të Diagnostikimit dhe Trajtimit, ku u vendos që pllaka që ishte vendosur gjatë operacionit të tij kurrizor duhej të hiqej. Ky rrezik padyshim që rritet me çdo lëvizje që mund të ndodhë gjatë një transferimi të përgatitur në mënyrë jo të duhur ose me lëvizje të papritura”. Në qershor 2010, ankimuesi u transferua edhe një herë në spitalin e burgut “Ezeiza”.

Sërish gjykata refuzoi kërkesën e autorit, duke pretenduar mungesë juridiksioni. Në të njëjtën datë, autori kërkoi përsëri masën arrest në kushte shtëpie të mbikëqyrtur nga gjykata, duke argumentuar se burgu “Ezeiza” nuk kishte as ambientet dhe as personelin e nevojshëm për rehabilitimin e pacientëve me kushte të rënda neurologjike.

Më 4 korrik 2011, burgu “Ezeiza” informoi Gjykatën Federale Penale se, megjithëse fizioterapia ofroheshin, ankimuesi refuzoi t’i nënshtrohet një trajtimi rehabilitimi. Për më tepër, më 19, 20 dhe 27 korrik 2011, ankimuesi refuzoi të transferohej në klinikën “Santa Catalina” për terapinë e rehabilitimit, duke argumentuar se klinika nuk mund të siguronte të gjitha shërbimet e kërkuara të rehabilitimit.

Më 15 gusht 2011, Gjykata Federale Penale refuzoi sërish kërkesën e autorit për masën arrest në kushte shtëpie. Ajo gjykoj që gjendja fizike dhe mjekësore e autorit nuk ishin të tilla që ta bënin të pamundur rikuperimin e tij gjatë qëndrimit në paraburgim ose në burg dhe, kur ishte e nevojshme, të transferohej diku tjetër në një ambulancë moderne me një mjek të pranishëm. Gjykata Federale Penale nuk gjeti prova se ai mund të trajtohej në mënyrë të përshtatshme dhe efektive vetëm në kushte shtëpie.

Shefi i shërbimit të rehabilitimit të spitalit kërkoi që një udhëtim i tillë të pezullohej derisa të mund të merrej një raport mbi pasojat e mundshme të atyre udhëtimeve nga një ekspert në çrregullimet e shtyllës kurrizore.

Më 7 dhjetor 2011, Departamenti i Mjekësisë Ligjore informoi Gjykatën Federale Penale se gjendja e autorit po përmirësohej dhe se ai kërkonte përdorimin e një karrigeje me rrota, një mbajtëse për shpinën dhe ndihmën e një personi tjetër. Ai gjithashtu deklaroi se ekzaminime të reja ishin të nevojshme për të konstatuar gjendjen e shpinës së tij dhe se mënyra më e mirë e trajtimit ishte rehabilitimi ambulator. Departamenti deklaroi se udhëtimi nga dhe në spital ishte i domosdoshëm.

Më 29 dhjetor 2011, Gjykata Federale e Krimeve përsëri refuzoi kërkesën e autorit për masën arrest në kushte shtëpie, duke përdorur të njëjtat argumente si më parë dhe duke thënë se ishin marrë disa masa, si: eliminimi i shkallës në banjë dhe përshtatja

e ambienteve, vendosja e butonit të emergjencës, sigurimi i shërbimit të infermierit 24 orë, ofrimi i karriges me rrota, ashensorë.

Sërisht ankimuesi apeloj. Zëvendës drejtori i spitalit të burgut “Ezeiza” informoi Gjykatën Federale Penale se fizioterapia ofrohej në qelinë e autorit, se ai kishte konsulta të rregullta në spitalin “San Juan de Dios”, se ai kujdesej për higjienën dhe nevojat në shtrat me ndihmën e personelit infermieror dhe se, nëse qëllimi do të ishte që ankimuesi të arrinte një pikë ku ai do të ishte në gjendje të plotësonte nevojat e tij të përditshme vetë, në mënyrë të pavarur, spitali i burgut nuk kishte infrastrukturën e duhur për atë qëllim.

Ankimuesi pretendon se raporti ishte i pasaktë dhe deformoi faktin që trajtimi i ofruar në burg ishte i papërshtatshëm.

Më 13 korrik 2012, Dhoma Federale refuzoi ankesën.

Më 12 tetor 2012, mjeku i stafit në spitalin e burgut raportoi se, për shkak të kohës që ankimuesi kishte kaluar i shtrirë, ai kishte hipotrofi të gjymtyrëve të poshtme. Ankimuesi deklaroi se gjatë kësaj periudhe ai nuk u transferua në kohën e duhur në një institucion të kujdesit shëndetësor të aftë për të trajtuar problemet e tij dentare, por u transferua vetëm disa muaj më vonë, kohë në të cilën tashmë duhej një ndërhyrje kirurgjikale.

Në 12 dhe 20 nëntor 2012 dhe 16 janar 2013, ankimuesi përsëriti ankesat e tij dhe informoi Komitetin se, përkundër urdhrave të Dhomës Federale, Gjykata Federale e Krimeve nuk kishte marrë masat e nevojshme për të siguruar hyrje të përshtatshme, në kohë në objektet e kujdesit shëndetësor. Autoritetet e burgut nuk kishin siguruar më shumë veçse një karrige të përshtatur pjesërisht, e cila nuk kishte elemente sigurie. Ai gjithashtu pohoi se sektori në të cilin ai ishte mbajtur kishte vetëm një infermiere për të gjithë pacientët e burgosur atje, dhe se, në praktikë, ai nuk ka marrë ndihmën e duhur ose në kohë. Më 14 nëntor 2012, instituti “FLENI” raportoi se autori kishte nevojë për terapi rehabilitimi intensive në një qendër shumë të sofistikuar. Autori paraqiti një kërkesë tjetër në të cilën kërkoi të transferohej dhe të pranohej në institutin “FLENI” ose në një qendër tjetër me burimet njerëzore dhe teknike të përshtatshme për nevojat e tij. Sidoqoftë, Gjykata Federale Penale e refuzoi aplikimin e tij.

Ankimuesi pretendon se, megjithëse nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme, ato mjete juridike janë zgjatur pa arsye, duke e bërë të pamundur që të arrihet një zgjidhje efektive. Ai thekson se, në praktikë, ai nuk merr trajtimin mjekësor të caktuar në kohën e duhur ose në mënyrë efikase dhe se integriteti i tij fizik dhe mendor rrezikohen seriozisht.

Shkeljet

Autori pretendon të jetë viktimë e shkeljeve nga Argjentina e neneve 9, 10, 13, 14, paragrafi 2, 15, paragrafi 2, 17, 25, dhe 26 të Konventës.

Ndërprerja e trajtimit të tij rehabilitues në institutin “FLENI” dhe mangësitë e përshkruara jo vetëm që cenojnë të drejtën e tij për standardin më të lartë të arritshëm shëndetësor pa diskriminim dhe të drejtën e tij për të arritur pavarësinë maksimale, por gjithashtu rrezikojnë seriozisht jetën e tij, në kundërshtim me nenet 25 dhe 26 të Konventës. Në praktikë, shërbimet e rehabilitimit të ofruara nga autoritetet thjesht përbëjnë kujdes paliativ dhe janë të pamjaftueshme për të sjellë rehabilitim të plotë. Asnjë i burgosur tjetër nuk është në një gjendje shëndetësore sikurse është ai, i varur tërësisht nga ndihma e të tjerëve, si pasojë, mbajtja e tij në një burg përbën shkelje të së drejtës së tij për barazi para ligjit.

Papërshtatshmëria e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar dhe kushtet nën standarde të paraburgimit dhe kujdesit shëndetësor në spitalin e burgut përbëjnë një cenim të dinjitetit të tij dhe trajtim çnjerëzor. Pasi ishte caktuar në një qeli të katit të parë në burg, ankimuesi nuk ishte në gjendje të hynte në oborrin e e pushimit për 8 muajt e parë të burgimit, duke e privuar atë nga aksesin në ajër të pastër dhe drita natyrore, në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 2, të Konventës.

Aksesi i tij në dush dhe tualet është i kufizuar për shkak të madhësisë së banjës, dhe ai mbështetet në ndihmën e infermierit të vetëm në bllokun e tij ose vullnetin e mirë të të burgosurve dhe rojeve të tjera. Puna dhe ndryshimet e kryera nga autoritetet e burgut për të hequr hapin që pengonte hyrjen e tij në banjë dhe dush nuk janë të mjaftueshme sepse madhësia e banjës nuk është e përshtatur për karriget me rrota; kështu që ai nuk është në gjendje të arrijë tualetin dhe dushin në mënyrë të pavarur. Gjendja e tij aktuale dhe mungesa e ndihmës nga të tjerët nuk e lejojnë atë të kujdeset për nevojat e tij të përditshme të higjienës. Modifikimet që u bënë në vendin e tij të paraburgimit janë të pamjaftueshme për të ndryshuar kushtet që dëmtojnë në mënyrë të pariparueshme shëndetin e tij fizik dhe mendor, në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, të Konventës.

Megjithëse ishte instaluar një buton thirrjeje, thirrjet shpesh nuk marrin përgjigje menjëherë dhe nganjëherë aspak. Ai ka zhvilluar lezione në një numër rastesh për shkak të mungesës së një dysheku të veçantë. Që prej mbërritjes së tij në burgun “Ezeiza”, ai nuk i është nënshtruar terapisë së duhur rehabilituese posturale ose

pamore, siç rekomandohet nga mjekët. Ai kurrë nuk i është nënshtruar trajtimit të rehabilitimit pamor siç përshkruhet nga stafi okulist. Ai u transferua në një spital vetëm pasi zhvilloi një infeksion që kërkonte operacion. Të gjitha sa më sipër përbëjnë shkelje të nenit 17 të Konventës.

Vlerësimi i Komitetit

Komiteti vëren se ankesat e autorit dhe informacioni vënë në pikëpyetje disa çështje që kërkojnë shqyrtim sipas neneve 9, 10, 14, paragrafi 2; 15, paragrafi 2; 17; 25; dhe 26 të Konventës dhe se ato konsiderohen të pranueshme.

Komiteti merr në konsideratë ankesën se ankimuesi është diskriminuar nga autoritetet, pasi ata nuk arritën të merrnin në konsideratë aftësinë e tij të kufizuar dhe gjendjen shëndetësore kur e vendosën në spitalin qendror të burgut të Kompleksit të Burgjeve “Ezeiza Federale” dhe gjithashtu mohuan përshtatjet e arsyeshme që nevojiteshin për sigurinë e tij personale. Kjo çoi në ndërprerjen e rehabilitimit të rekomanduar nga mjekët dhe shkeljen e të drejtës së tij për standardin më të lartë të shëndetit pa diskriminim, si dhe të së drejtës së tij për të jetuar në mënyrë të pavarur.

Informacioni që i është vënë në dispozicion Komitetit tregon se ankimuesi i është nënshtruar një operacioni në kurriz dhe se, gjatë operacionit, një pllakë ishte vendosur në mënyrë të gabuar. Ai ka pësuar një goditje në tru me pasoja të rënda, të cilat e lanë atë me një çrregullim të ekuilibrit shqisor, dëmtim të njohjes dhe shikimit.

Komiteti vëren, nga njëra anë, pretendimet e ankimuesit se qelia e tij në burgun “Ezeiza” është e papërshtatshme për një person me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, Komiteti ka marrë informacion nga shteti palë se autoritetet kanë bërë modifikimet e nevojshme për të hequr shkallën që pengonte hyrjen në banjë dhe dush. Për më tepër, autoritetet gjyqësore dhe zyrtarët e burgut dhe Shërbimi Ligjor Publik bënë vizita në qelinë e ankimuesit dhe konstatuan se ekzistonin ashensorë dhe ishin në gjendje pune, se një derë në oborr ishte pajisur posaçërisht për të akomoduar ankimuesin dhe butoni për të thirrur një infermiere ishte instaluar, me personelin infermieror që ishte në detyrë gjatë gjithë kohës.

Komiteti rikujton që, sipas nenit 14, paragrafi 2, i Konventës, personat me aftësi të kufizuara të privuar nga liria kanë të drejtë të trajtohen në përputhje me objektivat dhe parimet e Konventës, duke përfshirë sigurimin e një akomodimi të arsyeshëm. Më tej, rikujton se aksesueshmëria është një parim i përgjithshëm i Konventës dhe, si i

tillë, vlen edhe për situatat në të cilat personat me aftësi të kufizuara janë privuar nga liria e tyre. Shteti palë është i detyruar të sigurojë që burgjet të ofrojnë akses për të gjithë personat me aftësi të kufizuara të privuar nga liria. Prandaj, shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat përkatëse, përfshirë identifikimin dhe heqjen e pengesave për të hyrë, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të privuar nga liria të mund të jetojnë në mënyrë pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës së përditshme në vendin e tyre të paraburgimit. Masa të tilla përfshijnë sigurimin e aksesit të tyre, në mënyrë të barabartë me të tjerët, në fusha dhe shërbime të ndryshme, të tilla, si: banjë, oborre, biblioteka, zona studimi, punëtori dhe shërbime mjekësore, psikologjike, sociale dhe juridike. Në çështjen nën shqyrtim, Komiteti pranon përshtatjet e realizuara nga shteti palë në mënyrë që të hiqen pengesat që pengojnë hyrjen e autorit në zonat brenda mjedisit fizik të burgut. Sidoqoftë, Komiteti vëren se shteti palë nuk ka arritur të provojë në mënyrë të pakundërshtueshme se përshtatjet e bëra në kompleksin e burgut janë të mjaftueshme për të siguruar aksesin në mënyrë të pavarur, për aq sa është e mundur në banjë dhe dush, oborr dhe shërbimin e infermierisë. Komiteti vëren në lidhje me këtë se shteti palë nuk ka deklaruar që ka ndonjë pengesë që do ta ndalonte atë nga marrja e masave të nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e autorit dhe nuk mohoi pretendimet e ankimuesit se pengesat arkitektonike ekzistojnë. Si pasojë, Komiteti vëren se, në mungesë të shpjegimeve të mjaftueshme, shteti palë ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 9, paragrafët 1 (a) dhe (b), dhe nenit 14, paragrafi 2, të Konventës.

Duke arritur në përfundimin e mësipërm, dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, Komiteti vëren se, në dritën e mungesës së aksesit dhe përshtatjeve të arsyeshme në një nivel të kënaqshëm, autori është vendosur në kushte pa standardet që kërkohen nga neni 17 i Konventës.

Komiteti rikujton që mosmarrja e masave përkatëse dhe sigurimi i një përshtatjeje të arsyeshme kur ato kërkohen nga persona me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr liria mund të përbëjë shkelje të nenit 15, paragrafi 2, të Konventës. Në rastin konkret, megjithatë, Komiteti nuk vëren se ka prova të mjaftueshme para tij për të konkluduar se ka pasur një shkelje të nenit 15, paragrafi 2, të Konventës.

Në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe trajtimin rehabilitues Komiteti merr parasysh pretendimet e ankimuesit se ai nuk i është nënshtruar trajtimit rehabilitues të përshtatshëm ose në kohë që nga ardhja e tij në burgun “Ezeiza” dhe se kompleksi të burgut i mungon infrastruktura, pajisjet dhe personeli i kërkuar për të siguruar një trajtim të tillë. Komiteti më tej vëren edhe deklaratat e shtetit palë, sipas të cilave janë marrë hapa për sigurimin e terapisë rehabilituese ambulatorie në burgun

“Ezeiza” edhe në qendrat e afërta të kujdesit shëndetësor jashtë burgut, autori ka refuzuar t’i nënshtrohet terapisë rehabilituese në një numër rastesh dhe kërkesat e tij për autorizimin e arrestit në kushte shtëpie ose ndalimin në spital janë shqyrtuar siç duhet nga autoritetet.

Komiteti rikujton që, sipas nenit 25 të Konventës, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit pa diskriminim dhe se Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet shëndetësore, përfshirë rehabilitimin. Për më tepër, neni 26 përcakton që Shtetet Palë do të marrin masa efektive dhe të përshtatshme për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara për të arritur dhe ruajtur pavarësinë maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe përfshirjen e plotë dhe pjesëmarrjen në të gjitha aspektet e jetës, përmes gjithëpërfshirjes dhe shërbimet dhe programet e rehabilitimit në një mënyrë të tillë që ato të fillojnë në fazën më të hershme të mundshme dhe të bazohen në vlerësimin shumë disiplinor të nevojave dhe pikave të forta individuale. Në dritën e këtyre dispozitave, të lexuara në lidhje me nenin 14, paragrafi 2, Komiteti kujton se Shtetet palë kanë një përgjegjësi të veçantë për të mbrojtur të drejtat e njeriut kur autoritetet e burgut ushtrojnë kontroll ose pushtet të konsiderueshëm mbi personat me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr liria.

Në rastin konkret, nuk ka dyshim që autori ka nevojë për kujdes shëndetësor dhe rehabilitim. Komiteti është i vetëdijshëm se deklaratat e ankimesit dhe shtetit palë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e trajtimeve rehabilituese janë kontradiktore. Sidoqoftë, Komiteti vëren se, nga njëra anë, pretendimet e autorit nuk janë vërtetuar në një mënyrë plotësisht bindëse dhe se, nga ana tjetër, gjykatat kanë ndërmarrë hapa për t’iu përgjigjur nevojave mjekësore të autorit. Si pasojë, dhe duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, Komiteti nuk ka prova të mjaftueshme para tij për të arritur në përfundimin se ka shkelje të neneve 25 dhe 26 të Konventës.

Në dritën e informacionit që disponon, Komiteti nuk ka as prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se udhëtimi nga dhe në burg në një ambulancë të sofistikuar me një mjek të pranishëm, ose mbajtja në burg, përbëjnë një shkelje të neneve 10 ose 25 të Konventës.

Në këto rrethana, Komiteti, duke vepruar sipas nenit 5 të Protokollit Opsional të Konventës, është i mendimit se shteti palë ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 9, paragrafët 1 (a) dhe (b), nenit 14, paragrafi 2, dhe neni 17 të Konventës.

Rekomandimet e Komitetit

- Shteti palë është i detyruar të dëmshpërblejë për shkeljet e të drejtave sipas Konventës duke realizuar përshtatje në vendin e tij të paraburgimit për të siguruar hyrjen e tij në mjediset dhe shërbimet e burgut në kushte të barabarta me të burgosurit e tjerë;
- Shteti palë duhet gjithashtu të rimbursojë ankimesit për shpenzimet ligjore që lidhen me këtë komunikim;
- Për më tepër, duke pasur parasysh shëndetin delikat të ankimesit, Komiteti i kërkon shtetit palë të sigurojë që, ndërsa pacientët janë të lirë të bien dakord ose të refuzojnë trajtimin mjekësor, autori duhet të ketë qasje në kujdes shëndetësor të përshtatshëm, në kohë që është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore, si dhe qasje të plotë në terapi të përshtatshme rehabilituese rregullisht.

Shteti palë është i detyruar të ndërmarrë hapa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen. Në veçanti, shteti është i detyruar:

- Të miratojë masat e duhura dhe sigurimin e përshtatjes së arsyeshme sipas kërkesës, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr liria mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës në vendin e tyre të paraburgimit;
- Të miratojë masat e duhura dhe sigurimin e përshtatjeve të arsyeshme sipas kërkesës në mënyrë që të sigurohet se personat me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr liria, të kenë akses, në kushte të barabarta me personat e tjerë të privuar nga liria, në ambientet e ndalimit dhe shërbimet e ofruara atje;
- Të miratojë masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr liria të kenë qasje në trajtime mjekësore dhe rehabilituese në mënyrë që ata të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit pa diskriminim;
- Të sigurojë që, si pasojë e mungesës së aksesit ose përshtatjes së arsyeshme, kushtet e paraburgimit, në të cilat mbahen personat me aftësi të kufizuara nuk bëhen më të rënda ose shkaktojnë vuajtje më të mëdha fizike dhe psikologjike në një masë që do të përbënte trajtim çnjerëzor ose degradues, ose që do të cenonte integritetin e tyre fizik dhe mendor;
- Të sigurojë që ka trajnime të mjaftueshme, të rregullta për fushën e Konventës dhe Protokollit të saj Opsional për gjyqtarët, zyrtarët e tjerë gjyqësorë dhe zyrtarët e burgjeve, veçanërisht personelin e kujdesit shëndetësor.

Komunikimi Nr. 30/2015i paraqitur nga: Boris Makarov, në emër të gruas së tij të ndjerë, Glafira Makarova

Data e komunikimit: 2 mars 2015 (dorëzimi fillestar)

Data e miratimit të pamjeve: 18 Gusht 2017

Subjekti: Kapaciteti ligjor

Çështjet e trajtuara: Aksesi në gjykatë, ushtrimi i zotësisë juridike për të vepruar, përshtatja e arsyeshme.

Nenet e Konventës: 12, 13, 22, Neni 2 i Protokollit Opsional.

Ankimuesi pretendon se më 12 qershor 2005, gruaja e tij ishte viktimë e një aksidenti rrugor, i cili u shkaktua nga V.M. Si rezultat, gruaja e ankimuesit, Glafira Makarova pësoi lëndime të shumta trupore, përfshirë një dëmtim në kokë. Më 9 janar 2006, një komision mjekësor përpiloi një raport për aftësi të kufizuara në masën 60 përqind për znj. Makarova. Më pas, ajo gjithashtu vuante nga dhimbje koke. Sipas autorit, aftësia e kufizuar, dhimbja e kokës dhe humbja e kujtesës ishin pasojë e drejtpërdrejtë e dëmtimit të kokës që pësoi në aksident.

Ankimuesi pretendon se deri më 19 janar 2007, pasojat e dëmtimit në kokë ishin përkeqësuar deri në pikën kur gruaja e tij u diagnostikua me një raport për aftësi të kufizuara në masën 80%. Sipas autorit, gjendja e znj. Makarova vazhdoi të përkeqësohej deri në vdekjen e saj më 24 nëntor 2011.

Autori më tej pohon se për shkak të gjendjes shëndetësore, ajo nuk ishte në gjendje të shkonte personalisht në rajonin e policisë. Me anë të letrave të 25 janarit 2006 dhe 15 prillit 2006, ajo kërkoi që të informohej për hetimin penal të filluar kundër V.M. Ankimuesi pretendon se kërkesat u injoruan nga autoritetet. Ankimuesi pretendon se veprimet e zyrës së prokurorit ishin të paligjshme, pasi prokurori nuk arriti të informojë gruan e tij për akt-akuzën e V.M. më 2 maj 2006 dhe si pasojë, ajo u privua në mënyrë të paligjshme nga e drejta e saj për të kundërshtuar vendimet dhe konkluzionet e prokurorit.

Po kështu, për shkak të përkeqësimit të gjendjes së saj, znj. Makarova nuk mund të merrte pjesë në seancat gjyqësore. Me anë të një letre, ajo informoi gjykatësin që nuk do të ishte e pranishme gjatë seancave dhe nuk mund të punësonte një avokat për shkak të vështirësive financiare. Ankimuesi pretendon se neni 118 i Kushtetutës së Lituaniës vendos mbi prokurorin detyrimin për të mbrojtur pozicionin e viktimës nëse ai ose ajo nuk ka mundësi të sigurojë avokat dhe vendos mbi gjyqtarin detyrimin për të siguruar një mbrojtës për viktimën.

Ankimuesi parashtron, megjithatë, se këto kërkesa ishin injoruar dhe se gjykatësi zyrtarisht refuzoi t'i siguronte gruas së tij ndihmë juridike. Si rezultati kësaj, ankimuesi pretendon se gruas së tij iu mohua e drejta për akses në drejtësi dhe mbeti pa ndihmë juridike, çka çenoi të drejtën për mbrojtje të barabartë sipas ligjit.

Ankimuesi pretendon, për më tepër, se gjatë seancave dëgjimore publike gjykatësi zbuloi informacione konfidenciale për gjendjen shëndetësore të gruas pa dhënien e pëlqimit nga ana e saj. Sipas ankimuesit, veprimet e gjyqtarit përbëjnë shkelje të së drejtës së gruas së tij për privatësi, sipas nenit 22 të Konventës.

Ankimuesi është i mendimit se gjyqtari dhe prokurori vazhdimisht kanë favorizuar palën e akuzuar, në shkelje të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare. Në veçanti, ankimuesi pretendon se dokumenti që vërteton aftësinë e kufizuar të gruas së tij dhe historiku i shkeljeve administrative të V.M. nuk u morën në konsideratë dhe u përdorën prova të falsifikuara që zvogëlonin fajin e të akuzuarit dhe dëmtimin fizik të gruas së tij që u përshkrua si "i lehtë" dhe nuk kishte asnjë lidhje me gjendjen reale të saj të përkeqësuar të shëndetit. Si pasojë, ankimuesi paditi prokurorin dhe gjyqtarin për qëndrim të anshëm, por pa sukses.

Më 22 maj 2008, gjyqtari P. vendosi që V.M. ishte fajtor për kryerjen e një shkeljeje të rregullave të trafikut dhe përmes një akuze të lehtë me dënim në formën e një gjobe, pasi kishte arritur në përfundimin se aftësia e kufizuar e znj. Makarova nuk kishte lidhje me aksidentin. Ankimuesi pretendon se gruaja e tij ishte viktimë e aksidentit dhe se ajo nuk ishte informuar për atë gjykim. Në fakt, ankimuesi e zbuloi vendimin e gjykatës kur u paraqit në kancelarinë e gjykatës më 7 nëntor 2008.

Shkeljet

Ankimuesi pretendon se shteti palë ka shkelur të drejtat e gruas së tij sipas neneve 12 dhe 13 të Konventës.

Vlerësimi i Komitetit

Sa i përket pretendimeve të autorit sipas neneve 12 (3) dhe 13 (1), Komiteti duhet të vlerësojë nëse vendimet e shtetit palë në rastin e gruas së autorit kanë shkelur të drejtat e saj për njohje të barabartë para ligjit dhe akses në drejtësi. Komiteti vëren se znj. Makarova ishte viktimë e drejtpërdrejtë e aksidentit automobilistik në fjalë.

Komiteti vëren si një fakt të padiskutuëshëm se gruaja e autorit nuk mund të merrte pjesë në seancat gjyqësore për shkak të aftësisë së saj të kufizuar dhe se ajo nuk ishte e përfaqësuar në seanca, pavarësisht nga kërkesa e saj për t'i siguruar përfaqësim ligjor. Nëse do të ishte e pranishme vetë ose përmes përfaqësuesit znj. Makarova mund t'u kishte drejtuar pyetje dëshmitarëve, ajo mund të kishte sfiduar gjetjet e raporteve të ekspertimit në lidhje me shëndetin e saj dhe ajo mund të dëshmonte në rolin e dëshmitares mbi ngjarjen. Komiteti vëren se ankimuesi, duke vepruar në emër të gruas së tij, paraqiti një ankesë pasi vendimi i gjykatës i 22 majit 2008 hyri në fuqi. Komiteti gjithashtu vëren se gjykata e rrethit e refuzoi këtë kërkesë më 12 nëntor 2008 dhe më pas ky refuzim u konfirmua dhe nga gjykata rajonale. Për më tepër, gjykata e deklaroi vendimin e saj përfundimtar, i cili u konfirmua nga Gjykata e Lartë e Litanisë më 1 mars 2012. Përkundër paraqitjes së provave të forta se ankimuesi dhe gruaja e tij kurrë nuk morën një kopje të vendimit të gjykatës, gjykatat nuk gjetën “arsye të kënaqshme” për rivendosjen e afatit prej 20 ditësh për apelim. Komiteti vëren se shteti palë nuk ka adresuar pretendimet e ankimuesit. Shteti palë ka përcaktuar disa aspekte të kornizës ligjore për sigurimin e ndihmës juridike falas, duke pohuar që një viktimë ka të drejtë për një ndihmë të tillë juridike të garantuar nga shteti. Nga të dhënat e përfuara nga ankimuesi është e qartë se një avokat ishte caktuar vërtet për znj. Makarova, por ai nuk arriti të paraqitej në seanca. Komiteti kujton se sipas nenit 12 (3) të Konventës, shtetet palë kanë detyrimin të «marrin masat e duhura për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit ligjor”. Ai gjithashtu kujton se sipas nenit 13 (1), “Shtetet palë sigurojnë akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në të njëjtat kushte me të tjerët, përfshirë përmes sigurimit të akomodimeve procedurale dhe të përshtatshme për moshën, në mënyrë që të lehtësojnë rolin e tyre efektiv si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, përfshirë si dëshmitarë, në të gjitha procedurat ligjore, në fazat hetimore dhe fazat e tjera paraprake”. Komiteti vëren se ndërsa shtetet palë kanë njëfarë kufiri vlerësimi për të përcaktuar rregullimet procedurale për t'u dhënë mundësi personave me aftësi të kufizuara të ushtrojnë kapacitetin ligjor, të drejtat përkatëse të personit në fjalë duhet të respektohen. Kjo nuk ndodhi në këtë çështje, megjithëse si viktimë e drejtpërdrejtë e aksidentit në fjalë, znj. Makarova ishte qartësisht një “pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë” e procedurave përkatëse ligjore. Për Komitetin është gjithashtu e qartë se znj. Makarova dëshironte që pozicioni i saj të dëgjohej gjatë seancave gjyqësore, por asaj nuk iu dha asnjë formë akomodimi për ta bërë të mundur: ajo nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në seanca për shkak të aftësisë së saj të kufizuar. Ajo e informoi shtetin palë për këtë dhe i kërkoi shtetit palë që t'i sigurojë përfaqësim ligjor në shkallën e parë dhe ankimim, por asaj nuk iu dha ndonjë mbështetje. Duke marrë parasysh që shteti

palë nuk siguroi asnjë formë të përshtatjes së arsyeshme për Znj. Makarova për të marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe procedurën e ankimimit në lidhje me çështjen e saj, Komiteti vëren se shteti palë ka shkelur të drejtat e saj, sipas neneve 12 (3) dhe 13 (1) të Konventës.

Rekomandimet e Komitetit

- T'i sigurojë ankimesit një mjet efektiv juridik, duke përfshirë rimbursimin e çdo kostoje ligjore të shkaktuar prej tij dhe gruas së tij gjatë gjithë procedurave ligjore në nivel kombëtar, së bashku me kompensimin;
- T'i sigurojë ankimesit akses në të dhënat gjyqësore dhe hetimore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të, transkriptimet e të gjitha seancave gjyqësore dhe rezultatet e ekzaminimeve të ekspertëve, dhe në të gjithë dokumentacionin përkatës;
- Të publikojë këtë vendim (pikëpamje) dhe ta ndajë më publikun e gjerë në formate të arritshme në mënyrë që ato të jenë në dispozicion për të gjithë;
- Në përgjithësi, shteti palë është i detyruar të marrë masa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen. Në këtë drejtim, Komiteti gjithashtu i referohet rekomandimeve të përfshira në vëzhgimet e tij përfundimtare (CRPD/C/LTU/CO/1) dhe kërkon që shteti palë:
- Të miratojë ndryshimet e nevojshme në ligjet që rregullojnë sigurimin e ndihmës juridike për të përfshirë ndihmën juridike falas për personat me aftësi të kufizuara kur është e nevojshme;
- Të miratojë një plan kombëtar veprimi për të ngritur kapacitetin e personelit gjyqësor dhe të zbatimit të ligjit, përfshirë gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë dhe personelin e burgjeve, për të rritur njohuritë e tyre për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar sigurimin e procedurave dhe akomodimin e përshtatshëm për moshën në të gjitha procedurat ligjore;
- Të promovojë, sigurojë dhe monitorojë sigurimin e përshtatjes së arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët publikë dhe privatë dhe të njohë mohimin e përshtatjes së arsyeshme si një formë diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar.

PJESA II

GYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Rasti Glor kundër Zvicrës, 30.04.2009, Nr. 13444/04

Subjekti: Nëse vendimi administrativ ndaj kërkuesit për pagimin e një gjobe për moskryerjen e shërbimit ushtarak përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të kërkuesit.

Nenet e KEDNJ: 14, 8

Faktet

Ankimuesi quhet Sven Glor dhe është një shtetas zviceran, i cili ka lindur në vitin 1978. Ai jeton në Dallikon (kantoni i Zyrihut) dhe është shofer kamioni. Në vitin 1997, kërkuesi u vlerësua nga një mjek si i papërshtatshëm për të kryer shërbimin ushtarak për shkak të diabetit. Në vitin 1999, ai u lirua nga detyrimi për të shërbyer në Shërbimin e Mbrojtjes Civile. Paskëtaj, ai u caktua në rezervat e mbrojtjes civile. Në vitin 2001, autoritetet i dërguan kërkuesit një urdhër pagese për të paguar taksën e moskryerjes së shërbimit ushtarak për vitin 2000 në vlerën 477 euro. Kërkuesi e apeloj urdhërpagesën duke pretenduar se ai ishte viktimë e diskriminimit. Ai deklaroi që kishte pasur gjithmonë dëshirë për të kryer shërbimin ushtarak, por ishte shpallur si i paafte për shkak të diabetit. Në vitin 2001, zyra Federale e Administrimit të Taksave njoftoi kërkuesin se të gjithë meshkujt zviceranë, të cilët nuk vuanin nga një aftësi e kufizuar “domethënëse” duhet të paguanin taksën për moskryerjen e shërbimit ushtarak. Ndërkohë, njoftimi theksonte se në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Federale zvicerane kriteri për aftësi të kufizuar fizike ose psikologjike nënkuptonte një prag prej të paktën 40% të aftësive të prekura nga aftësia e kufizuar. Përmes një vendimi të korrikut 2003, autoritetet kompetente vlerësuan se në bazë të një ekzaminimi mjekësor të bërë nga një mjek specialist, kërkuesi nuk mund të përjashtohet nga pagesa e taksës për aq kohë sa aftësitë e tij të kufizuara ishin më pak se 40%. Bordi i Apelit të Taksave Federale la në fuqi vendimin. Në vitin 2004, Gjykata Federale rrëzoi apelin administrativ të kërkuesit dhe z. Glor duke u mbështetur në nenin

14 të marrë së bashku me nenin 8, u ankua se ishte diskriminuar në atë që ishte parandaluar kundër vullnetit të tij për të kryer shërbimin e tij ushtarak, ndërsa ishte i detyruar të paguante taksën e përjashtimit pasi aftësia e tij e kufizuar nuk konsiderohej si “thelbësore” nga autoritetet.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se neni 14 i Konventës garanton mbrojtjen nga diskriminimi me qëllim gëzimor e të gjithë të drejtave dhe lirive të garantuara nga parashikimet e tjera substanciale të Konventës dhe Protokolleve të saj. Megjithatë, jo çdo trajtim i ndryshëm sjell shkelje të këtij neni. Ai garanton, që individë të ndryshëm, të cilët ndodhen në situata të ngjashme të mos gëzojnë trajtim preferencial, sepse kjo është diskriminuese (shih National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society k. Mbretërisë së Bashkuar, 23 tetor 1997, § 88, Raportet 1997VII, dhe Zarb Adami k. Maltës, nr. 17209/02, §71, GjEDNJ 2006-VIII).

Në bazë të jurisprudencës së Gjykatës, një trajtim i ndryshëm është diskriminues në kuptim të nenit 14, nëse ai nuk është ndërmarrë në bazë të një objektivi dhe justifikimi të arsyeshëm. Ekzistenca e një justifikimi duhet të shqyrtohet në lidhje me qëllimin dhe pasojat e masës së ndërmarrë dhe parimet që mbizotërojnë normalisht në një shoqëri demokratike. Një trajtim i ndryshëm në lidhje me një të drejtë të garantuar nga Konventa nuk duhet vetëm të ndiqet nga një qëllim legjitim: neni 14 shkelet edhe kur është qartësisht e dukshme që nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme përpjesëtimërie mes masës së ndërmarrë dhe qëllimit që është dashur të realizohet (shih Zarb Adami, cituar më lart, § 72; Stec dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar [DHOMA E MADHE], nr. 65731/01, § 51, GjEDNJ 2006-VI; Petrovic, cituar më lart, § 30; dhe Lithgow dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, 8 korrik 1986, § 177, Seria A nr. 102). Me fjalë të tjera, nocioni i diskriminimit përfshin, në përgjithësi, çështje kur një individ ose grup individësh është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme së të tjerët, pa një justifikim të vlefshëm, edhe pse trajtimi më i favorshëm nuk është bërë në justifikim të Konventës (shih Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali, cituar më lart, § 82). Neni 14 nuk ndalon trajtimin e ndryshëm, i cili i ka arsyet në rrethanat tërësisht të ndryshme dhe të cilat janë të bazuara në interesin publik, duke përfshirë edhe një balancë të drejtë mes mbrojtjes së interesit të komunitetit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa (shih ndër të tjera G.M.B. dhe K.M. k. Zvicrës, nr. 36797/97, 27 shtator 2001, dhe Zarb Adami, cituar më lart, § 73). Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të përligjur një trajtim të ndryshëm për situata

të ngjashme. Qëllimi i hapësirës së vlerësimit varet nga rrethanat e çështjes në fjalë dhe mjedisi (shih Frették. Francës, nr. 36515/97, § 40, GjEDNJ 2002; Stec dhe të Tjerët, cituar më lart, §52; Rasmussen k. Danimarkës, 28 nëntor 1984, § 40, Seria A nr. 87; dhe Inze k. Austrisë, 28 tetor 1987, § 41, Seria A nr. 126).

Për sa kohë Konventa është kryesisht një sistem i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Gjykata duhet të ketë parasysh ndryshimin e kushteve në Shtetet Palë dhe t'i përgjigjet për shembull çdo konsensusi që shfaqet lidhur me standardet që duhet të arrihen. Një ndër faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e hapësirës së vlerësimit që i lejohet autoriteteve mund të jetë ekzistenca ose mos ekzistenca e një baze konsensuale apo marrëveshjeje mes ligjeve të Shteteve Palë (shih Rasmussen, cituar më lart, § 40, dhe mutatismutandis, The SundayTimes k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1), 26 prill 1979, § 59, Seria A nr. 30). Konventa dhe Protokollet e saj duhen interpretuar në dritën e kushteve të tanishme (shih Tyrer k. Mbretërisë së Bashkuar, 25 prill 1978, § 31, Seria A nr. 26; Airey k. Irlandës, 9 tetor 1979, § 26, Seria A nr. 32; dhe Vo, cituar më lart, § 82). Së fundmi, Gjykata thekson se në bazë të jurisprudencës së saj të konsoliduar, Konventa ka qëllim të garantojë jo vetëm të drejta teorike ose imagjinare, por të drejta, që janë praktike dhe efektive (shih për shembull: Artico k. Italisë, 13 maj 1980, § 33, Seria A nr. 37). Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete ekziston një shembull i trajtimit të ndryshëm të individëve, që ndodhen në situata të ngjashme. Duke qenë se lista e ndryshimeve të parashikuara në nenin 14 nuk është shteruese ("ose çdo status tjetër"); shih: Stec dhe të Tjerët, cituar më lart, § 50), nuk ka dyshim se ky parashikim përfshin diskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara. Mbetet për t'u vlerësuar, nëse arsyet për të cilat është ndërmarrë një trajtim i ndryshëm ishin objektive dhe të arsyeshme. Gjykata vëren se qëllimi i ligjit zviceran është krijimi i një forme barazie mes individëve, që kryejnë shërbimin ushtarak ose civil dhe atyre që përjashtohen nga ky shërbim. Atëherë, duhet të vlerësohet nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme përpjesëtimërie mes masave të ndërmarrura dhe qëllimit, që është dashur të arrihej përmes tyre. Për këtë qëllim, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse autoritetet dhe gjykatat zvicerane kanë mbajtur një balancë të drejtë mes mbrojtjes së interesit të komunitetit në tërësi dhe të drejtave e lirive që kërkuesit i garantohen nga Konventa. Gjykata thekson se Zvicra mbledh taksa nga të gjithë qytetarët meshkuj, të cilët për arsye të caktuara nuk kanë të mundur të kryejnë shërbimin ushtarak dhe nuk kryejnë as shërbimin zëvendësues civil, me përjashtim të atyre, që kanë aftësi të kufizuara serioze. Megjithatë, ky fakt i marrë veçmas nuk është vendimtar për të vlerësuar një ankim në kuadër të nenit 14 të Konventës. Gjykata vëren se kjo lloj takse, e vendosur edhe për meshkujt, që vuajnë nga ndonjë aftësi e kufizuar fizike dhe të cilët nuk e kanë të mundur të kryejnë shërbimin ushtarak, nuk duket se ekziston në vende të tjera, të paktën në Evropë. Gjykata vlerëson se

detyrimi i kërkuesit për të paguar një taksë, sepse është përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e shërbimit ushtarak (ose civil) mund të jetë në kundërshtim me nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj individëve me aftësi të kufizuara, duke penguar pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre në shoqëri. Gjykata vëren se e vetmja arsye e paraqitur nga qeveria për legjislacionin në fjalë është mbajtja e një barazie mes individëve, të cilët e kryejnë shërbimin ushtarak ose civil dhe atyre, që nuk e kryejnë atë. Në çështjen konkrete objekt gjykimi, individi në fjalë ishte diagnostikuar nga ana e autoriteteve me shëndet jo të përshtatshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Gjykata gjithashtu theksoi se roli kompesues i taksës ishte i vogël, duke parë se forcat e armatosura zvicerane kishin një numër të mjaftueshëm njerëzish të disponueshëm në shërbimin ushtarak. Më tej vërejtje se një taksë e këtij lloji nuk ekzistonte në shumicën e vendeve të tjera. Në bazë të të dhënave rezultoi se vitet e fundit mbi 40% e të gjithë meshkujve diagnostikohen si jo të përshtatshëm nga pikëpamja shëndetësore për shërbimin ushtarak. Në bazë të këtij informacioni, që zotëron Gjykata, në kohën që po gjykohej çështja, përqindja e individëve, që marrin përfitime nga aftësitë e tyre të kufizuara është e ulët. Ndërkohë, një numër i madh individësh detyrohen të paguajnë taksën e kompensimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se të ardhurat e fituara nga pagimi i kësaj takse nuk mund të neglizhohen. Gjykata vëren se taksa, që i është kërkuar ankuesit të paguajë për vitin 2000 është rreth 477 euro. Është e vërtetë se kjo shumë përfaqëson vetëm 2% të rrogës së kërkuesit, por nuk mund të konsiderohet si e parëndësishme, nëse shqyrtohet niveli modest i taksimit të të ardhurave të tij. Për më tepër, duhet mbajtur parasysh se kjo taksë duhet paguar çdo vit, për aq kohë sa detyrimi i tij ushtarak të zgjasë, për individët në moshën 20 deri në 30 vjeç, ose edhe deri në 34 vjeç. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta vlerësojë vlerën financiare simbolike. Gjykata thekson se është detyrë kryesore e autoriteteve vendase, kryesisht e gjykatave, për të interpretuar dhe zbatuar ligjin vendas (shih Winterwerpk. Holandës, 24 tetor 1979, § 46, Seria A nr. 33). Megjithatë, Gjykata vlerëson se mënyra sipas të cilës kanë vepruar autoritetet në çështjen në fjalë është e diskutueshme. Së pari, ata vetëm krahasuan sëmundjen e kërkuesit, e cila nuk e pengon atë të punojë me rastin e një individi, i cili ka humbur këmbën për shkak të një aksidenti dhe arritën në përfundimin se aftësia e kufizuar e kërkuesit nuk prek 40% të aftësive të tij të përgjithshme. Gjykata çmon se duke marrë në konsideratë vetëm një kriter vlerësimi, bazuar në një rast tjetër, i cili nuk mund të krahasohet, autoritetet zvicerane kanë dështuar në shqyrtimin në mënyrën e duhur të situatës së kërkuesit.

Në bazë të parashikimit të legjislacionit dhe jurisprudencës së Gjykatës Federale zvicerane, pasi janë diagnostikuar një herë aftësitë e tij të kufizuara, kërkuesi nuk mund të kundërshtojë faktin se një individ me një aftësi të kufizuar minimale nuk është gjendur i diskriminuar në ambientin e punës. Me fjalë të tjera, kërkuesi nuk

mund të ankohej se të ardhurat e tij ishin relativisht modeste dhe për rrjedhojë detyrimi për të paguar taksën ishte jo përpjesëtimor në këtë rast. Shteti i paditur u detyrua të paguante kërkuuesin, brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhej përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 i Konventës, 3,650 EUR (tre mijë e gjashtë) njëqind e pesëdhjetë euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet aplikuesit, në lidhje me kostot dhe shpenzimet për çështjen.

Rasti Çam kundër Turqisë

Aplikimi Nr. 51500/08, datë 23 Shkurt 2016

Subjekti: Nëse mohimi i të drejtës për asimim përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të kërkuarit

Faktet e çështjes

Kërkuuesja ka lindur në 1989 dhe jeton në Stamboll. Më 15 qershor 2004 ajo aplikoi për të marrë pjesë në konkursin e hyrjes për Akademinë Kombëtare të Muzikës Turke. Më 21 dhe 31 gusht 2004 ajo dha provimin në bağlama. Më 7 shtator 2004, sektori i muzikës në administratën e Akademisë publikoi një listë të kandidatëve të suksesshëm në provimin pranues, i cili përfshinte edhe kërkuuesen. Ankuesja menjëherë aplikoi në një komision mjekësor në Spitalin Publik Büyükçekmece për një raport mjekësor që verifikonte aftësinë e saj për të studiuar në Akademinë e Muzikës. Komisioni mjekësor përpiloi një raport ku thuhej se kërkuesi ishte diagnostikuar me hipermetropi me nistagmus dhe ambliopi të rëndë bilaterale dhe referoi një komision mjekësor të një niveli më të specializuar. Më 16 shtator 2004 një komision mjekësor në Spitalin Kërkimor dhe Trajnues Bakırköy (spitali “Bakırköy”) vlerësoi se kërkuuesja mund të ndiqte arsimin dhe mungesa e shikimit nuk përbënte pengesë. Në të njëjtën ditë, Drejtori i Akademisë së Muzikës i kishte kërkuar kërkuueses që të paraqiste raportin mjekësor ose përndryshe nuk do të kishte mundësi ta regjistronte. Më 20 shtator 2004, babai i kërkuarit i shkroi Drejtorit të Akademisë së Muzikës për ta informuar atë se raporti mjekësor i ishte përcjellë Akademisë së Muzikës të njëjtën ditë, siç kërkohej. Gjithashtu në të njëjtën ditë, Drejtori i Akademisë së Muzikës i shkroi Drejtorit Kryesor të spitalit “Bakırköy” dhe duke iu referuar raportit të lëshuar nga komisioni mjekësor i atij spitali, ai informoi që shikimi përbën një kriter

pa të cilin një student nuk mund të arsimohet në asnjë nga shtatë sektorët e Akademisë së Muzikës dhe i kërkoi që të përpilonte një raport të ri ku të mbahej parasysh ky kriter. Në një datë të paspecifikuar, Akademia e Muzikës refuzoi kërkesën e kërkueses për regjistrim. Më 24 shtator 2004, prindërit e ankueses, në emër të saj, paraqitën në Gjykatën Administrative të Stambollit (“Gjykata Administrative”) një padi kundër administratës së Universitetit Teknik të Stambollit për të hedhur poshtë vendimin e Akademisë së Muzikës për të mosregjistruar vajzën e tyre. Në kërkesat e tij, avokati për aplikantin argumentoi se klientja kishte kaluar provimin dhe se më 31 gusht 2004 ajo kishte fituar konkursin përfundimtar të pranimit me nota të plota. Citimi i kriterëve për pranim në Akademinë e Muzikës (domethënë moshë), avokati për ankuesen deklaroi se ajo i kishte përbushur të gjitha kriteret që ishin: moshë mbi pesëmbëdhjetë vjeç, dëshmi e arsimit fillor, që ka aftësitë e nevojshme fizike për të luajtur instrumentin e zgjedhur në të cilin është kërkuar regjistrimi, duke mos pasur një aftësi të kufizuara fizike, të tillë që ta parandalojë atë të studiojë në degën e zgjedhur dhe të fitojë në bazë të konkurrencës. Regjistrimi i saj në Akademinë e Muzikës ishte refuzuar për arsyen e vetme se ajo ishte e verbër, gjë që ishte në kundërshtim me ligjin dhe parimin e barazisë. Universiteti Teknik i Stambollit deklaroi se babai i kërkueses nuk kishte dhënë asnjë dokument që i referohej verbërisë së saj kur e kishte regjistruar. Universiteti pretendoi se ai e kishte fshehur me qëllim atë fakt para administratës. Gjithashtu universiteti pranon se rregullorja përmban kriterin “pa aftësi të kufizuara”. Për më tepër, kërkuesja nuk kishte sjellë një raport mjekësor që vërtetonte se ajo mund të studioje në Akademinë e Muzikës, kërkesë, e cila zbatohet për të gjithë aplikantët për pranim. Refuzimi për të regjistruar kërkuesen nuk ishte për shkak të verbërisë së saj, por nga mosparaqitja e dokumenteve të nevojshme për regjistrim brenda afatit. Ai shtoi se edhe pse raporti mjekësor i paraqitur pohonte që ajo mund të studioje në degën e Akademisë ku shikimi ishte i panevojshëm, por që në fakt nuk kishte degë të tilla. Së fundmi, universiteti vuri në dukje se në mungesë të mjediseve të përshtatshme dhe stafit mësimor me ekspertizën e duhur, Akademia e Muzikës nuk ishte në gjendje të siguroje arsimim për studentët e verbër, apo për personat me ndonjë lloj aftësie të kufizuar. Në lidhje me këtë shpjegoi se më 1976, kur ishte hapur, Akademia e Muzikës kishte shpresuar të prezantonte lehtësi për mësimin e studentëve të verbër, por mungesa e mësuesve me një komandë të shkrimit braille e kishte detyruar t’i braktiste përpjekjet. Më 14 tetor 2004, Gjykata Administrative hodhi poshtë kërkesën për ndalimin e ekzekutimit. Prindërit e kërkueses apeluan kundër vendimit. Ata argumentuan se në përputhje me nenin 27 2 të Aktit Nr. 2577, kishte pasur dy parakushte për marrjen e një ndalimi të ekzekutimit: ekzistenca e dëmit, i cili ishte i riparueshëm ose vështirësish i riparueshëm, dhe paligjshmëria e dukshme e aktit administrativ në fjalë. Prindërit deklaruan se në rrethanat e çështjes në fjalë ishte e qartë se refuzimi për të

regjistruar vajzën e tyre në Akademinë e Muzikës do t'i shkaktonte dëm asaj, një dëm, i cili do të ishte i vështirë të rregullohej. Ata gjithashtu thanë se një refuzim i tillë ishte i paligjshëm. Ata theksuan se përveç verbërisë së saj, ajo kishte të gjitha kapacitetet e nevojshme fizike për të luajtur bağlama. Për më tepër, ajo kishte kaluar provimin pranues për Akademinë e Muzikës, dhe një raport mjekësor kishte vërtetuar se ajo nuk kishte ndonjë aftësi të kufizuar të tillë që ta ndalonte atë të merrte arsim në departamentin e muzikës. Ata parashtruan se raporti mjekësor nuk mund të kontestohet pasi studentë të tjerë kishin siguruar raporte mjekësore nga institucione të ngjashme dhe Akademia e Muzikës i kishte pranuar. Sipas mendimit të tyre, fakti që raporti nuk kishte përmendur posaçërisht se aplikanti mund të studioje në Akademi nuk mund ta zhvleftësonte atë. Për më tepër, ata argumentuan se argumenti i administratës së paditur se raporti mjekësor nuk ishte dorëzuar me kohë, ishte i gabuar, pasi ai raport ishte dorëzuar në Akademinë e Muzikës të hënën 20 shtator 2004, domethënë në ditën e parë të punës pas marrjes së letrës nga Akademia që kërkonte raportin. Prindërit e aplikantit dhanë emrat e katër të diplomuarve të verbër të Akademisë së Muzikës. Ata ish-studentë kishin pohuar se verbëria nuk ishte pengesë për të luajtur një instrument muzikor, se kishte shumë muzikantë të verbër dhe se argumenti i Akademisë së Muzikës se askush nga pedagogët nuk dinte braille ishte i pavlefshëm bazuar në zhvillimet e teknologjisë. Më 28 tetor 2004 Gjykata Rajonale e Stambollit Administrativ hodhi poshtë atë ankesë me arsyetimin se kushtet për një pezullim të ekzekutimit të përcaktuara në nenin 27 § 2 të Ligjit Nr. 2577 nuk ishte përmbushur pasi ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar nuk ishte i tillë që të shkaktonte dëm që ishte i riparueshëm ose i vështirë për t'u riparuar dhe nuk ishte i paligjshëm. Gjithashtu drejtuesi i spitalit "Bakırköy" i shkroi administratës së Akademisë së Muzikës për ta informuar atë se raporti mjekësor i datës 16 shtator 2004 ishte rishikuar. Më 11 Mars 2005, duke vepruar në emër të kërkueses dhe në emër të saj, prindërit e saj paraqitën një ankesë tek Prokurori i Shtetit Bakırköy kundër Spitalit të Kërkimit dhe Trajnimit të Bakırköy, Zyrtarit Kryesor Mjekësor të saj dhe mjekëve të tjerë që kishin ndryshuar raportin mjekësor të 16 shtatorit 2004, duke i akuzuar ata për shpërdorim detyre. Ata argumentuan se mjekët kishin ndryshuar raportin mjekësor në mënyrë arbitrare, pa ekzaminuar vajzën e tyre. Ata pohuan se qëllimi i ndryshimeve kishte qenë të siguronin që procedimet kundër administratës së Universitetit të Stambollit të përfundonin në favor të këtij të fundit. Në të njëjtën ditë, ata bënë një ankesë edhe në Urdhër të Mjekut të Stambollit. Prokurori refuzoi ndjekjen penale në fjalë. Më 18 korrik 2005 ata bënë një apel në Gjykatën Administrative të Stambollit duke kërkuar anulimin e vendimit për të mos regjistruar kërkuesin. Gjykata Administrative rrëzoi ankesën e ankuesit. Gjykata Administrative e miratoi atë vendim me shumicë votash, në kundërshtim me rekomandimin e kryetarit të gjykatës, i cili miratoi një mendim mospajtues, duke përmendur nenin 42 të Kushtetutës dhe Ligjin

Nr. 1739, se askush nuk mund të privohej nga e drejta e tij ose e saj për arsim dhe udhëzim. Më 18 prill 2006, prindërit e kërkuesses, paraqitën një apel në çështjet e ligjit pranë Këshillit të Shtetit kundër vendimit të Gjykatës Administrative. Ata parashtruan që ai vendim ishte në kundërshtim me Kushtetutën, me legjislacionin kombëtar dhe me disa instrumente dhe deklarata ndërkombëtare. Këshilli i Shtetit hodhi poshtë ankesën. Sipas informacionit të transmetuar në Gjykatë nga kërkuessa, pas refuzimit të kërkesës së saj në Akademinë e Muzikës, ajo vazhdoi arsimin e saj në një shkollë të zakonshme para se të fillonte me Departamentin e Muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit Marmara.

Vlerësimi i gjykatës

Gjykata vëren se kriteret për regjistrim në Akademinë e Muzikës përfshinin kriterin për të siguruar një certifikatë mjekësore të aftësisë fizike për t'u pranuar në atë institucion. Në përputhje me rrethanat, arsyt fillestare për mohimin e regjistrimit në Akademinë e Muzikës nga aplikanti nuk qëndronin në ligj, por në rregulloret e Akademisë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren më tej nga gjykimet në gjykatat vendase se Akademia e Muzikës nuk ishte në gjendje të pranonte persona me aftësi të kufizuar. Prandaj, në çështjen në fjalë, Gjykata duhet të konstatojë nëse, shteti që ka vendosur të ofrojë arsim të specializuar muzikor, mund t'ia ndalojë aksesin një grupi personash në veçanti, pasi diskriminimi përfshin rastet kur një person ose grup trajtohet, pa justifikim, në mënyrë më pak të favorshme se një tjetër, megjithëse trajtimi më i favorshëm nuk kërkohet nga Konventa (shih: Glor, cituar më lart, § 73). Gjithashtu, megjithëse është vërtetë që të gjithë aplikantët duhet të sigurojnë një vërtetim mjekësor në lidhje me aftësinë e tyre fizike, Gjykata nuk mund të anashkalojë efektet e kësaj kërkesë tek persona të tillë si kërkuessi që kanë një aftësi të kufizuar duke pasur parasysh, në veçanti mënyrën në të cilën Akademia në fjalë interpreton këtë kërkesë. Gjykata vëren se ankuesja me të vërtetë i dorëzoi administratës një raport mjekësor mbi gjendjen e saj fizike, edhe pse me një rezervë lidhur me verbërinë e saj. Sidoqoftë, Akademia e Muzikës e refuzoi atë raport, duke arritur deri aty sa të kërkojë ndryshime në të nga zyrtari që e kishte hartuar. Si pasojë, edhe pse Akademia u përpoq të justifikonte refuzimin e saj për të regjistruar kërkuessen me dështimin e saj për të përmbushur formalitetet e kërkuara administrative, dhe në veçanti mungesën e një raporti mjekësor të përgatitur nga një spital i një niveli të caktuar, Gjykata vëren, pa dyshime, duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, si dhe letrën nga Drejtori i Akademisë së Muzikës drejtuar spitalit "Bakırköy" se verbëria e kërkuesses ishte arsyeja e vetme e refuzimit

dhe konstaton se aplikanti në çdo rast nuk do të ketë qenë në gjendje të përmbushë kërkesën e aftësisë fizike, pasi përkufizimi i kësaj të fundit me sa duket u la në dorë të Akademisë. Në lidhje me këtë Gjykata gjithashtu i referohet kritikave të shprehura për atë çështje nga Bordi Drejtues i Urdhrit të Mjekut të Stambollit.

Gjykata vëren se shteti argumentoi rregullat për regjistrimin në Akademinë e Muzikës para së gjithash me faktin se Akademia ishte krijuar për të pranuar vetëm studentë me talent të veçantë Megjithëse Gjykata vëren se autoritetet vendase në mënyrë të padiskutueshme kanë një margjin vlerësimi në përcaktimin e cilësive të kërkuara nga aplikantët në Akademinë e Muzikës, ky argument nuk mund të qëndrojë në rrethana të veçanta të çështjes në fjalë. Nëse Akademia e Muzikës synon të sigurojë arsimim për studentë të talentuar, duke qenë se aplikanti kishte kaluar provimin, ajo zotëronte të gjitha cilësitë e nevojshme në këtë drejtim. Gjykata vë në dukje rëndësinë e parimeve themelore të universalitetit dhe mosdiskriminimit në ushtrimin e së drejtës për arsim, të cilat janë mishëruar në shumë tekste ndërkombëtare (shih: Catan dhe të tjerët, cituar më lart, §§ 77-81). Më tej thekson se ato instrumente ndërkombëtare e kanë njohur arsimin gjithëpërfshirës si mjetin më të përshtatshëm për garantimin e parimeve themelore të lartpërmendura. Gjykata thekson se Konventa synon të garantojë të drejta praktike dhe efektive dhe jo parime teorike dhe jo të përgjithshme. Gjykata thekson se neni 14 i Konventës duhet të lexohet në dritën e kërkesave të atyre teksteve në lidhje me përshtatjen e arsyeshme - kuptohet si “modifikimi dhe rregullimet e domosdoshme dhe të përshtatshme që nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuara ose të panevojshme, kur është e nevojshme në një rast të veçantë” - të cilën personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë ta kenë për të siguruar «gëzimin ose ushtrimin mbi të njëjtën bazë me të tjerët të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore» (neni 2 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara...) Një përshtatje e tillë ndihmon për të korrigjuar pabarazitë faktike, të cilat janë të pajustificueshme dhe për këtë arsye përbëjnë diskriminim. Gjykata është e vetëdijshme që çdo fëmijë ka nevojat e tij specifike arsimore, dhe kjo vlen veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në fushën e arsimit, Gjykata pranon që përshtatja e arsyeshme mund të marrë një larmi formash, qofshin ato fizike ose jofizike, arsimore ose organizative, në aspektin e aksesit arkitektonik të ndërtesave shkollore, trajnimit të mësuesve, përshtatjes kurrikulare ose pajisjeve të përshtatshme. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se nuk është detyra e saj të përcaktojë burimet që do të caktohen për të përmbushur nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Autoritetet kombëtare, parimisht, janë në një pozicion më të mirë se sa një gjykatë ndërkombëtare për të vlerësuar nevojat dhe kushtet në këtë drejtim. Sidoqoftë, Gjykata mendon se është e rëndësishme për Shtetet që të jenë

veçanërisht të kujdesshëm në këtë fushë duke pasur parasysh ndikimin e këtyre të fundit tek fëmijët me aftësi të kufizuara, ndjeshmëria e veçantë e të cilëve nuk mund të neglizhohet. Rrjedhimisht, vëren se diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar gjithashtu përfshin refuzimin për të realizuar përshtatjete arsyeshme. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se autoritetet vendase në asnjë moment nuk u përpoqën të identifikonin nevojat e kërkueses ose të shpjegonin se si verbëria e saj mund të kishte penguar aksesin e saj në arsim. Ata nuk morën në konsideratë në asnjë moment përshtatjet fizike për të përmbushur ndonjë nevojë të veçantë arsimore që lind nga verbëria e kërkueses (shih: McIntyre kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 29046/95, Vendimi i Komisionit i 21 tetorit 1998, i pabotuar). Gjykata vëren se që nga viti 1976 Akademia e Muzikës nuk ka bërë asnjë përpjekje për të përshtatur metodat e saj të mësimdhënies në mënyrë që t'i bëjë ato të arritshme për studentët e verbër. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata vëren se refuzimi për të regjistruar aplikanten në Akademinë e Muzikës u bazua vetëm në faktin se ajo ishte e verbër dhe se autoritetet e brendshme nuk kishin konsideruar në asnjë moment mundësinë që realizimi i përshtatjes e arsyeshme mund t'i kishte mundësuar asaj arsimimin. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkueses iu refuzua, pa ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm mundësia për të studiuar në Akademinë e Muzikës, por refuzimi ndodhi vetëm për shkak të aftësisë së saj të kufizuar. Prandaj, ajo konstaton se ka pasur një shkelje të Nenit 14 të Konventës të marrë në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1

Guberina kundër Kroacisë **Aplikimi Nr. 23682/13, datë 22.3.2016**

Subjekti: Diskriminim në lidhje me një aplikim të padrejtë të legjislacionit tatimor vendas.

Çështjet e trajtuara: Mosmarrja në konsideratë e nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara kur përcaktohet aftësia e babait aplikant për lehtësimin e taksave për blerjen e pronës së përshtatur në mënyrë të përshtatshme: shkelje.

Faktet

Kërkuesi kishte në pronësi një banesë në Zagreb në katin e tretë të një ndërtese banimi, ku ai jetonte me gruan dhe dy fëmijët e tij. Në vitin 2003, tre vjet pasi ai

kishte blerë banesën, gruaja e aplikantit lindi fëmijën e tyre të tretë. Fëmija ishte me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Pas lindjes, fëmija ka pasur një sërë ndërhyrjesh mjekësore dhe gjendja e tij ishte nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të shërbimeve kompetente të kujdesit social. Në prill të vitit 2008 një komision ekspertësh diagnostikoi fëmijën me paralizë cerebrale të pashërueshme, aftësi të kufizuara të rëndë intelektuale dhe epilepsi. Në shtator të vitit 2008 shërbimet sociale e deklaruan fëmijën 100 për qind me aftësi të kufizuara. Ndërkohë, në shtator të vitit 2006, kërkuesi bleu një shtëpi në Samobor, dhe në tetor 2008 e shiti banesën e tij. Sipas ankuesit, arsyeja për blerjen e një shtëpie ishte fakti se ndërtesa ku ndodhej apartamenti i tij nuk kishte ashensor dhe për këtë arsye nuk i plotësonte nevojat e fëmijës së tij me aftësi të kufizuara dhe familjes së tij. Në mënyrë të veçantë, ishte shumë e vështirë për të marrë djalin e tij nga banesa për ta vizituar te mjeku, ose për ta çuar atë në fizioterapi dhe në kopsht ose në shkollë, dhe për të përmbushur nevojat e tij të tjera sociale. Më 19 tetor 2006, pasi kishte blerë shtëpinë në Samobor, aplikanti paraqiti një kërkesë për përjashtimin e taksave tek autoritetet tatimore. Ai u mbështet në nenin 11 (9) të Ligjit për Taksat e Transferimit të Pronave të Paluajtshme, i cili ka dhënë një mundësi të përjashtimit tatimor për një person, i cili ishte duke blerë një apartament ose një shtëpi në mënyrë për të zgjidhur nevojat e tij ose të saj të banimit, dhe në qoftë se ai ose ajo, apo anëtarët e familjes së tij, nuk kanë një banesë ose shtëpi që plotëson nevojat e tyre për strehim. Në kërkesën e tij ankuesi argumentoi se shtëpia që zotëronte nuk i plotësonte nevojat e banimit të familjes së tij pasi ajo ishte shumë e vështirë, dhe në fakt bëhet e pamundur, për të çuar fëmijën e tij me aftësi të kufizuara nga kati i parë në atë të tretë, pa ashensor, duke pasur parasysh se ai qëndronte në një karrocë. Prandaj, ankuesi parashtrroi se ai kishte blerë shtëpi në mënyrë që të zgjidhë nevojat e djalit të tij. Kjo kërkesë u hodh poshtë më argumentin se nuk përmbushte kërkesat e ligjit, pasi banesa përmbush kushtet për të jetuar në të, dhe nuk përbënte subjekt për përjashtim nga taksat.

Zyra e Taksave Samobor urdhëroi aplikantin që të paguante rreth 11250 euro në tatime. Kërkuesi apeloi kundër vendimit të mësipërm të Ministrisë së Financave, e cila nuk e pranoi.

Më 7 shtator 2009, ankuesi depozitoi një ankim administrativ në Gjykatën e Lartë Administrative, e cila gjithashtu hodhi poshtë pretendimet e tij. Më 25 maj 2012, ankuesi depozitoi një ankesë kushtetuese para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, miratoi arsyetimin e organeve më të ulëta, duke hedhur poshtë ankesën kushtetuese të kërkuesit si të pabazuar, për arsye se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.

Vlerësimi i gjykatës

Për vlerësimin e saj, Gjykata i është referuar Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe pjesëve përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të ratifikuar nga Kroacia më 15 gusht 2007, duke përmendur specifikisht, përshtatjen e arsyeshme, mosdiskriminimin dhe aksesueshmërinë dhe një sërë nenesh të tjera.

Çështja në fjalë ka të bëjë me një situatë në të cilën kërkuesi nuk pretendon trajtim diskriminues lidhur me aftësinë e kufizuar të tij, por në vend të kësaj trajtim të pafavorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së tij, me të cilin ai jeton dhe për të cilin ai ofron kujdes. Me fjalë të tjera, në këtë rast shtrohet pyetja se në çfarë mase aplikanti, i cili nuk i përket vetë një grupi të diskriminuar, vuan nga një trajtim më pak i favorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së tij? Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se trajtimi i pretenduar si diskriminues i aplikantit për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së tij, me të cilin ai ka lidhje të ngushta personale dhe për të cilin ai ofron kujdes, është një formë e diskriminimit me bazë në aftësitë e kufizuara të mbuluara nga neni 14 i Konventes. Paraqitet çështja nëse banesa në fjalë mund të konsiderohet si vendstrehim i përshtatshëm për nevojat e banimit të familjes së aplikantit pas lindjes së fëmijës së tij me aftësi të kufizuara. Sipas mendimit të Gjykatës, nuk ka dyshim se apartamenti i aplikantit në Zagreb, i blerë tre vjet para lindjes së djalit të tij, i vendosur në katin e tretë të një ndërtese banimi, pa një ashensor, dëmton rëndë lëvizshmërinë e djalit të tij dhe si pasojë kërcënon zhvillimin e tij personal dhe aftësinë për të arritur potencialin e tij maksimal, duke e bërë jashtëzakonisht të vështirë për të që të marrë pjesë në komuniteti dhe në aktivitetet edukative, kulturore dhe sociale të fëmijëve. Prandaj, Gjykata konstaton se duke kërkuar për të ndryshuar banesën në fjalë, duke blerë një shtëpi që ishte e përshtatshme për nevojat e familjes së tij, aplikanti ishte në një pozitë me çdo person tjetër, i cili kishte ndryshuar vendbanim, duke blerë një tjetër pronë të paluajtshme, sipas normave të legjisllacionit përkatës të brendshëm tatimor, infrastrukturës bazë dhe kërkesave teknike të akomodimit. Gjendja e tij, megjithatë, ndryshon në lidhje me kuptimin e termit “kërkesat e infrastrukturës bazë”, e cila, në funksion të aftësisë së kufizuar të djalit të tij dhe standardeve relevante kombëtare dhe ndërkombëtare, nënkupton edhe aksesin e nevojshëm në objekte të tilla si, në rastin konkret, ekzistenca e një ashensori. Megjithatë, Gjykata vëren se Zyra e Taksave Samobor mori parasysh se, duke pasur parasysh sipërfaqen e banesës në pronësi të kërkuesit në Zagreb dhe ekzistencën e infrastrukturës, si ujë, energji elektrike dhe qasje në shërbimet e tjera publike, nuk mund të thuhet se ankuesi nuk kishte kushte. Prandaj,

ai u përjashtua nga përfitimi i uljes në tatim për blerjen e një prone që përmbush në të vërtetë nevojat e banimit të familjes së tij. Gjykata konstaton se nuk ka asnjë dyshim se autoritetet kompetente vendore nuk njohin specifikat faktike të gjendjes së ankuesit në lidhje me çështjen e infrastrukturës bazë dhe kërkesat e akomodimit teknik që plotësojnë nevojat e banimit të familjes së tij. Autoritetet vendase mbajtën një pozicion kufizues në lidhje me rastin konkret të aplikantit, duke mos marrë parasysh nevojat specifike të aplikantit dhe familjes së tij. Qeveria ngriti dy argumente për justifikimin e vendimeve të autoriteteve vendase. Së pari, Qeveria argumentoi se legjislacioni i brendshëm parashikon kritere objektive për vërtetimin e kushteve themelore të infrastrukturës të vendbanimit, i cili nuk lejon asnjë liri në vendimmarrje për autoritetet administrative tatimore; dhe së dyti, se kërkuesi nuk kishte përmbushur kërkesat financiare për përjashtim nga taksat për shkak të gjendjes së tij financiare. Për sa i përket argumentit të parë, Gjykata nuk mund të mos vërejë se Qeveria, me vullnetin e saj nuk ka fuqizuar autoritetet përkatëse në vend, për të ndërtuar një marrëdhënie të rregullt përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që duhet të arrihet në rastin e veçantë të aplikantit. Për këtë arsye, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të Konventës, autoritetet nuk ishin në gjendje të ofronin justifikim objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me dështimin e tyre për të korrigjuar pabarazinë faktike përkatëse në rastin e aplikantit. Gjykata vëren, megjithatë, duke qenë e vetëdijshme se është së pari detyrë e autoriteteve kombëtare, kryesisht gjykatave, të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjin e brendshëm, e se dispozita përkatëse e Ligjit për Shitjen e Pronave të Patundshme është shprehur në terma të përgjithshme dhe duke iu referuar vetëm “infrastrukturës bazë” dhe “kërkesave higjienike dhe teknike”. Më tej, Gjykata vëren se dispozitat e tjera përkatëse të ligjit të brendshëm japin disa udhëzime në lidhje me çështjen e kërkesave themelore të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Kështu me ligj, për personat me lëvizshmëri të kufizuar parashikohet prania e një ashensori në ndërtesën ku ata jetojnë. Megjithatë, nuk ka asgjë që sugjeron se ndonjë nga autoritetet kompetente të vendit në rastin në fjalë e vëren ligjin e brendshëm, të aftë për të plotësuar kuptimin e termave sipas Ligjit për Shitjen e Pronave të Patundshme.

Në rastin në fjalë, megjithatë, autoritetet përkatëse vendase nuk kanë marrë në konsideratë këto detyrime ndërkombëtare. Çështja në këtë rast është mënyra në të cilën legjislacioni është zbatuar në praktikë, i cili nuk arriti të akomodojë mjaftueshëm kërkesat e veçanta të rasti të aplikantit që lidhen me aftësinë e kufizuar të fëmijës së tij dhe, në veçanti, me interpretimin e termit “kërkesat bazë të infrastrukturës” për strehimin e një personi me aftësi të kufizuara. Gjykata vëren se në parim, mbrojtja e personave financiarisht në nevojë, duke zbatuar masat përkatëse të përjashtimit

të taksave mund të konsiderohet si arsytim objektiv për një trajtim diskriminues. Në të vërtetë, kjo duket si çështja e gjendjes financiare të një individi që aplikon për lirim nga tatimi për transferimin e një pronë të paluajtshme ishte me domethënie për çështjen së bashku me faktorë të tjerë gjatë vlerësimit të detyrimit të tij ose të saj tatimor. Megjithatë, në lidhje me rastin konkret të aplikantit, gjykata vëren se arsyeja e përjashtimit të aplikantit nga lirimi i tatimi është se apartamenti i tij në Zagreb i përmbushte kushtet për të strehuar familjen e tij. Referenca e vetme për elementin financiar të dispozitës së përjashtimit të taksave sipas Ligjit për Shitjen e Pronave të Patundshme është bërë nga Ministria. Megjithatë, kjo është bërë pa ndonjë vlerësim konkret të aspekteve përkatëse financiare të rastit të aplikantit, një praktikë kjo e ndjekur herë të tjera në rastet e ngjashme me atë të aplikantit. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe në veçanti në mungesë të vlerësimit përkatës të të gjitha rrethanave të rastit nga autoritetet kompetente vendore, Gjykata nuk është e mendimit se ata dhanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për dështimin e tyre për të marrë në konsideratë pabarazinë me vend për situatën e aplikantit kur bënë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1.

Gjykata paraqet mundësitë që ka aplikanti në dispozicion për të kërkuar rihapjen e procedurës në pajtim me nenin 76 të Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative, e cila do të mundësonte një shqyrtim të freskët e pretendimit të tij në nivel kombëtar.

Nga ana tjetër, Gjykata çmon se kërkuesi duhet të ketë pësuar dëm jomonetar, i cili nuk kompensohet mjaftueshëm me konstatimin e shkeljes. Duke vendosur mbi baza të barabarta, ajo i jep ankimesit 5,000 EUR në lidhje me dëmin jomonetar, plus çdo taksë që mund të jetë e tatueshme mbi këtë shumë.

Gjykata çmon të arsyeshme të caktojë shumën e 11 500 EUR për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore para gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare.

